



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 598 Akti**

**Nr. 345 Vendimi**  
**Tiranë, më 15.2.2021**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Pamela Qirko**  
**Firdes Shuli**  
**Etleda Çiftja**

**Kryesues**  
**Relator**  
**Anëtare**

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datat 12.2.2021 dhe 15.2.2021, në Pallatin e Koncerteve, kati i dytë, salla 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Alma Ahmeti**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, si dhe shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, e cila nëpërmjet përfaqësueses së saj ligjore, znj. Romina Zano, me nr. licence 7805, sipas prokurës nr. 319 rep., nr. 72 kol., datë 10.2.2021, në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Alma Ahmeti, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit” (në vijim Komisioni), është zhvilluar shorti në datën 16.7.2020, në përfundim të të cilit, rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Etleda Çiftja dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.
3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.
4. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2016, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2019, ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti.
5. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2020, DSIK-ja vuri në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. \*\*\* , datë 27.10.2020, të KDZH-së.
6. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2020, KLGJ-ja ka vënë në dispozicion raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti.
7. Me vendimin nr.1, datë 23.7.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Alma Ahmeti, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Pamela Qirko. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
8. Në datën 3.8.2020, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Në datën 5.8.2020, nëpërmjet komunikimit elektronik, subjekti deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.
9. Me vendimin nr. 2, datë 2.2.2021, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.
10. Në datën 3.2.2021 përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 10.2.2021; (iii) njohjen me provat e

administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

**11.** Në datën 8.2.2021, subjekti i rivlerësimit informoi Komisionin në rrugë elektronike se që prej datës 6.2.2021 ishte konfirmuar pozitiv me COVID 19, duke shprehur gatishmërinë e përfaqësimit në vijim të procedurave nëpërmjet zgjedhjes së një përfaqësuesi ligjor.

**12.** Në datën 10.2.2021, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, dërgoi shpjegimet në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht.

**13.** Me vendimin nr. 3 datë 10.02.2021, trupi gjykues, vendosi mbylljen e hetimit administrativ për të tria kriteret dhe kalimin në seancë dëgjimore, duke e njoftuar subjektin me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 12.2.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, si dhe duke i dhënë të drejtën e përfaqësimit nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor.

**14.** Në datën 12.2.2021, u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti u përfaqësua nga, përfaqësuesja ligjore, znj. R. Z., avokate pranë Dhomës së Avokatëve Tiranë, me numër licence \*\*\*, e cila kërkoi në emër të subjektit Alma Ahmeti, konfirmimin në detyrë të saj.

## **II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI**

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

Në zbatim të nenit 31/1, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, ka dorëzuar pranë këtij institucioni deklaratën e pasurisë në datën 27.1.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2009, me numër indeksi 9104, dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private në vijim.

ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Alma Ahmeti, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

#### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjekteve të rivlerësimit, referuar Vendimit Nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, i cili nuk është bazuar dhe as është detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.

Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka hetuar të gjitha faktet dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, duke kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreu VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49, të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi administrativ, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklaratimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

### **Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, si vijojnë:**

1. Në përdorim, sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 21.1.2017, pasuri e paluajtshme me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e ndodhur në z. k. \*\*\*, me sip. 76.90 m<sup>2</sup>, e llojit apartament, i ndodhur në adresën Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, e regjistruar në emër të prindërve të bashkëshortit B. dhe D. A.. Pasuria është blerë me kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme (me kusht) me nr. \*\*\*, datë 7.6.2007, dhe deklaratë noteriale për plotësimin e kushtit të shitjes nr. \*\*\*, datë 2.12.2008, të lidhur me palën shitëse F. dhe V. A. Vlera: 65,000 euro. Pjesa takuese në %, zero (0), pasi nuk disponon pjesë por vetëm jeton në këtë apartament.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni në lidhje me këtë pasuri**

Fillimisht u verifikua statusi i kësaj pasurie sipas deklaratimeve të subjektit. Me kërkesë të Komisionit:

- ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana-Jug<sup>1</sup>, informoi se pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit apartament me sip. 76.90 m<sup>2</sup>, rezulton e regjistruar në emër të shtetasve B. A. dhe D. A.;

- FSHU-ja<sup>2</sup> informoi për disa kontrata të furnizimit me energji të lidhura në emër të shtetasit B. A., pa identifikuar se cila kontratë i përket këtij apartamenti. Gjatë hetimit administrativ, me qëllim identifikimin e kontratës së furnizimit me energji që i përket pasurisë objekt shqyrtimi në Tiranë, iu kërkuua subjektit të paraqesë librezën e furnizimit me energji elektrike, dhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, znj. Alma Ahmeti, deklaroi se kontrata e furnizimit me energji elektrike e këtij apartamenti është lidhur në emër të abonentit B. A., duke paraqitur si prova shkresore: (1) librezat e energjisë elektrike të lëshuara nga ish-KESH dhe ish-CEZ Shpërndarje, nga të cilat rezulton se në emër të shtetasit B. A. në adresën Rr. “Mustafa Lleshi”, është lidhur kontrata e furnizimit me energji elektrike me nr. \*\*\*; (2) shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2020, nga FSHU-ja drejtuar subjektit Alma Ahmeti, sipas të cilës në emër të shtetasit B. P. A. është lidhur kontrata e furnizimit me energji me Nr. \*\*\*.

<sup>1</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2020, nga ASHK-ja, Tirana Jug në dosjen e Komisionit.

<sup>2</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2020, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

- UKT-ja<sup>3</sup> nuk konfirmoi kontratë për shërbime ujësjellës – kanalizime në Tiranë, në emër të shtetasit B. A.. Me kërkesë të Komisionit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se kontrata e furnizimit me ujë e këtij apartamenti është lidhur në emër të abonentit B. A., duke paraqitur librezën e lëshuar nga UKT-ja për apartament me adresë Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, nga e cila rezulton se në emër të shtetasit B. A. është lidhur kontrata e furnizimit me ujë nr. \*\*\*.

### **1.1 Në lidhje me origjinën e pasurisë dhe fitimin e pronësisë nga aktet<sup>4</sup> në dosje rezultoi se:**

- Pasuria nr. \*\*\*, apartament me sip. 76.9 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, sh. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, ka qenë e regjistruar në emër të shtetasve F. A. dhe V. A. të cilët e kanë fituar pronësinë me kontratën e shitblerjes së datës 7.12.1993.

- Me kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 7.6.2007, shtetasit B. dhe D. A., kanë blerë nga shtetasit F. dhe V. A. apartamentin me sip. 76.90 m<sup>2</sup>, me çmim 65,000 euro. Sipas kësaj kontrate, në datën e lidhjes së saj është paguar në *cash*, jashtë zyrës noteriale, shuma prej 47,000 euro, ndërsa pas çlirimit nga barra hipotekore të apartamentit, do të likuidohet edhe shuma tjetër prej 18,000 euro dhe do të përpilohet një tjetër akt noterial për kalimin e pronësisë.

- Me deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 2.12.2008, palët në kontratën e shitjes kanë deklaruar se është likuiduar shuma prej 18,000 euro.

- Në kartelën e pasurisë së paluajtshme është bërë dhe ndryshimi i pronësisë nga shtetasit F. e V. A. te shtetasit B. e D. A..

### **1.2 Në lidhje me përdorimin e këtij apartamenti, nga deklaratimet e subjektit dhe dokumentet shkresore të administruara, ka rezultuar se:**

Në të gjitha deklaratimet periodike, duke nisur prej DPFD-së për vitin 2009, subjekti ka deklaruar si adresë regjistrimi në gjendjen civile: Njësia Bashkiake Nr. 2, Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, vërtetuar edhe me vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016, lëshuar nga Njësia Bashkiake Nr. 2<sup>5</sup>.

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1 subjekti ka deklaruar gjithashtu përdorimin për shkak të martesës të këtij apartamenti në pronësi të prindërve të bashkëshortit, nga viti 2009 dhe në vijim, duke sqaruar se ky apartament është blerë prej tyre fillimisht për vajzën e tyre B. A., e cila ka qenë studente në Tiranë (vërtetuar me librezë studenti), dhe për këtë shkak, subjekti dhe bashkëshorti kanë jetuar së bashku me të deri në vitin 2013. Por kjo pasuri, sipas subjektit, nuk është deklaruar si pasuri e dhënë në përdorim, për shkak se pasuria nuk i është dhënë asnjëherë në përdorim nga prindërit e bashkëshortit, në kuptim të një sendi që jepet në përdorim.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, pas pyetjes në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të kësaj pasurie në DPV sipas ligjit, subjekti vijoi të deklarojë se pasuria nuk i është dhënë asnjëherë në përdorim nga prindërit e bashkëshortit në kuptim të një sendi që jepet në përdorim, duke argumentuar se në çdo deklaram ka deklaruar si adresë banimi adresën e kësaj pasurie “Rr. \*\*\*\*, p. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Kodi Postar \*\*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë”.

<sup>3</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2020, nga UKT-ja, në dosjen e Komisionit.

<sup>4</sup> Shihni aktet në Aneksin 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2020, nga ASHK-ja, Tirana Jug në dosjen e Komisionit.

<sup>5</sup> Shihni aktet në aneksin 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

Subjekti, për të vërtetuar pretendimet e saj, ka paraqitur dokumentet shkresore, si vijojnë:

- certifikatë personale lëshuar në datën 24.11.2020, në të cilën pasqyrohet si adresë vendbanimi adresa: Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 21.1.2017, në të cilën prindërit e bashkëshortit konfirmojnë deklaratimet e subjektit.

Duke qenë se në deklaratimet e subjektit ka pasur paqartësi në lidhje me faktin nëse në këtë banesë, kanë jetuar edhe prindërit e bashkëshortit të saj, nga Komisioni u kërkuan sqarime të mëtejshme. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, znj. Alma Ahmeti, ka shpjeguar se *prindërit e bashkëshortit B. dhe D. A. kanë banuar në Sarandë dhe për shkak se gjatë ditëve të javës kanë qenë në marrëdhënie pune pranë Drejtorisë së Bujqësisë Sarandë, vinin në Tiranë për të qëndruar në apartament gjatë fundjavave nga e premtja në deri të dielën, si dhe në ditët e festave zyrtare. Subjekti vijoi të deklarojë se ata kanë banuar gjatë gjithë kohës pa shkëputje, në Sarandë, në apartamentin me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 97 m<sup>2</sup>, me adresë Lagje nr. \*\*\*, p. \*\*\*, Rruga nr. \*\*\*, Kodër, Sarandë, e blerë prej tyre sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 15.7.1998, dhe se ata kanë punuar pa shkëputje në Drejtorinë e Bujqësisë Sarandë deri në vitin 2013 kur dolën në pension. Edhe pas daljes në pension, ata kanë vazhduar të banojnë dhe punojnë në Sarandë në biznesin e djalit të tyre E. A., farmaci veterinarë. Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur:*

- kartelën e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 19.1.2020, lëshuar nga ASHK-ja Sarandë dhe gjithë praktika e regjistrimit të kësaj pasurie;
- vërtetimet nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2020. dhe nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2021, të FSHU-së, sipas të cilave vërtetohet se shtetasi B. A. përveç kontratës së furnizimit me energji në Tiranë, është abonent edhe për një kontratë furnizimi me energji në Sarandë, me Nr. \*\*\*\*, në të cilën evidentohen të dhëna mbi periudhën e faturimit duke nisur që nga marsi vitit 2009 e deri në vitin 2021;
- vërtetimet nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2020, nr. \*\*\* prot., datë 19.1.2021, të Ujësjellës Kanalizime Sarandë, sipas të cilave vërtetohet se shtetasi B. A. ka kontratë me UK-në Sarandë me nr. \*\*\* nga ku referuar detajeve të klientit, pagesat e faturave nisin që nga viti 2006 dhe deri në vitin 2020;
- librezat e kontratave të furnizimit me energji elektrike dhe ujë në emër të shtetasit B. A. në të cilat evidentohen të dhëna të pagesave që në vitin 1998;
- ekstraktet e regjistrimit pranë QKB të datës 19.1.2021 dhe vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.1.2021, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, me të cilat vërtetohet se shtetasi B. A. është tatimpagues me NIPT \*\*\*, me objekt veprimtarie “farmaci veterinarë”, Sarandë, me datë regjistrimi 3.9.2015, pas çregjistrimit të personit fizik “E. A.”.

Përveç dokumenteve të paraqitura nga subjekti, gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni ka administruar vërtetimet e pagave të shtetasve B. dhe D. A., sipas të cilave, ata kanë punuar në qytetin e Vlorës dhe Sarandës<sup>6</sup>.

Nga të gjitha sa më sipër, u vërtetua se prindërit e bashkëshortit të subjektit, B. dhe D. A., që nga viti 2009 kur është blerë pasuria e në vijim (por jo vetëm), kanë banuar dhe punuar në qytetin e Sarandës. Apartamenti objekt shqyrtimi në Tiranë është banuar nga subjekti dhe

<sup>6</sup> Z. B. A. ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë Vlorë nga viti 1994 deri në gusht të vitit 2013, kur ka dalë në pension. Ndërsa znj. D. A. ka punuar në disa institucione në qytetin e Sarandës, nga viti 1994 - prill 2011 dhe nga prill 2011 deri në dhjetor 2013 ka punuar në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë Vlorë. Të dy bashkëshortet kanë dalë në pension në vitin 2013.

bashkëshorti i saj që nga vitin 2009 dhe, në vijim, gjatë periudhës 2009 – 2013 edhe nga motra e bashkëshortit, znj. B. A..

### 1.3 Për sa i takon lidhjeve të subjektit me këtë pasuri

Pavarësisht se pasuria objekt shqyrtimi u vërtetua të jetë blerë nga prindërit e bashkëshortit, para se subjekti i rivlerësimit të martohej me bashkëshortin dhe para se të bëhej subjekt deklarues, duke qenë se është përdorur prej saj për një periudhë 11 vjeçare e në vijim, shtetasit B. dhe D. A. konsiderohen persona të tjerë të lidhur, sipas parashikimit të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Me qëllim evidentimin e çdo lloj lidhjeje të mundshme të subjektit me këtë pasuri, gjatë procesit të rivlerësimit u kryen verifikimet si vijojnë:

**1.3.1** Referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, u pyet subjekti për burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, edhe pse ka rikonfirmuar faktin se nuk ka asnjë lidhje me pasurinë objekt shqyrtimi, subjekti ka dhënë shpjegime të hollësishme duke deklaruar se burimi i të ardhurave për blerjen e apartamentit janë: (i) bonot e thesarit që janë disponuar nga të ardhurat familjare; (ii) shuma 1,000,000 lekë nga shitja e një shtëpie njëkatëshe në qytetin e Sarandës sipas kontratës nr. 646/164 kol., datë 9.4.1999; (iii) të ardhurat nga pagat dhe kursimet e tjera familjare të tyre, duke dhënë sqarimet përkatëse për secilin prej burimeve. Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka vënë në dispozicion disa dokumente shkresore nga marrja në shqyrtim e të cilave rezultoi se:

**Së pari**, për sa i takon bonove të thesarit, nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të z. B. A.<sup>7</sup> u konstatua se bonot e thesarit në shumën 8,250,000 lekë<sup>8</sup> janë maturuar në datën 24.5.2007 dhe një pjesë janë transferuar te shtetasi M. P., si vijon: në datën 28.5.2007 shuma 2,500,000 lekë; dhe në datën 4.6.2007 shuma 3,224,000 lekë. Në total shuma prej 5,724,000 lekësh ose 47,340 euro është kaluar në llogarinë e shtetasit M. P.<sup>9</sup>, me qëllimin për t'u këmbyer nga lekë në euro dhe për t'u paguar apartamenti sipas kontratës së nënshkruar në datën 7.6.2007. Ndërsa shuma e mbetur prej 2,500,000 lekësh, është riinvestuar në bono thesari të cilat janë maturuar në datën 20.11.2008. Kjo shumë prej 2,500,000 lekësh është tërhequr në datën 25.11.2008 nga z. B. A. për t'u paguar kësti i dytë më 2.12.2008.

**Së dyti**, për sa i takon të ardhurave në shumën 1,000,000 lekë përfituar nga shitja e një shtëpie njëkatëshe në qytetin e Sarandës, subjekti ka vënë në dispozicion kontratën nr. \*\*\*, datë 9.4.1999, kontratë e cila vërteton këtë të ardhur. Në lidhje me pagimin e tatimit mbi shitjen, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se prindërit e bashkëshortit nuk e disponojnë fizikisht mandatpagesën e tatimit 0,5% të të ardhurave nga shitja, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, duke nënvizuar se pasuria e paluajtshme nuk regjistrohej pa u provuar pagimi i detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme nga ana e shitësit. Gjithashtu, ka vënë në dispozicion shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2020, nga ASHK-ja Sarandë, e cila informon se nuk disponon kopje të mandatpagesës së tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e kësaj pasurie, duke vënë në dispozicion praktikën e plotë të regjistrimit të kontratës së shitblerjes, nga ku rezulton se pasuria është regjistruar në emër të blerësit V. V.<sup>10</sup>.

<sup>7</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2020, nga "Raiffeisen Bank", vënë në dispozicion të Komisionit.

<sup>8</sup> Shuma prej 8,250,000 lekësh është krijuar nga dy depozita me afat në total në shumën 7,456,321.28 lekë. Të dyja depozitat vijnë nga data 30.9.2004. Këto depozita janë investuar dhe riinvestuar, deri sa është krijuar shuma 8,250,000 lekë.

<sup>9</sup> Shtetasi M. P., sipas sqarimeve të subjektit, është kambist valutor.

<sup>10</sup> Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi te ardhurat, i ndryshuar", neni 11, pika 2, parashikon se: "Tatimi paguhet nga individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme,

**Së treti**, në lidhje me burimin e krijimit “*të ardhura nga pagat dhe kursime të tjera familjare*”, nga aktet e administruara rezultoi se të ardhurat e dokumentuara nga pagat e familjes Ahmeti. nga viti 1994 e deri në datën 7.6.2007<sup>11</sup> kanë qenë në shumën 5,147,124 lekë. Duke shtuar dhe të ardhurën prej 1.000.000 lekësh përfituar nga shitja e pasurisë në Sarandë, në total të ardhurat e ligjshme të dokumentuara të familjes Ahmeti., deri në blerjen e pasurisë, kanë qenë në shumën 6,147,124 lekë. Ndërkohë, subjekti ka sqaruar se prindërit e bashkëshortit përveç të ardhurave nga marrëdhëniet e punës kanë pasur edhe të ardhura të tjera, pasi janë me profesion veterinerë dhe kanë ushtruar në vazhdimësi veprimtari private për shërbime veterinarë në gjithë rrethin e Sarandës. Për veprimtarinë e ushtruar gjatë kësaj periudhe, nuk rezultoi të kenë qenë të regjistruar si persona fizike apo juridike.

**1.3.2** U verifikuan të gjitha llogaritë bankare të subjektit, bashkëshortit të saj, prindërve të bashkëshortit dhe motrës së bashkëshortit dhe nuk rezultoi asnjë transaksion bankar në emër të subjektit dhe të bashkëshortit që të tregojë pagesa të kryera për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi.

**1.3.3** Nuk rezultoi asnjë akt shkresor në emër të subjektit dhe bashkëshortit, që ka lidhje me pasurinë objekt shqyrtimi.

**1.3.4** FSHU-ja dhe UKT-ja, nuk konfirmuan kontrata furnizimit me energji dhe ujë në emër të subjektit apo bashkëshortit për këtë pasuri.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur, për sa i takon lidhjeve të subjektit me këtë pasuri, u vërtetua se :

i) Pasuria objekt shqyrtimi është blerë nga prindërit e bashkëshortit të subjektit me kontratën noteriale nr. \*\*\*, datë 7.6.2007, të cilët, pasi kanë likuiduar tërësisht çmimin e shitjes, kanë regjistruar pasurinë në ZVRPP-në Tiranë në vitin 2008.

ii) Znj. A. A., pasi ka kryer studimet e magjistraturës në periudhën tetor 2006 – tetor 2009, ka filluar stazhin profesional në datën 7.1.2009, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

iii) Znj. Alma Ahmeti e celebruar në martesë me z. E. A. në datën 18.7.2008, ka filluar të banojë në këtë pasuri në janar të vitit 2009, vit në të cilin është bërë subjekt deklarues, duke deklaruar rregullisht në të gjitha DPV-të në vijim, adresën e kësaj pasurie, si adresë banimi të gjendjes civile.

iv) Që prej vitit 2009 dhe në vijim kjo pasuri është përdorur realisht prej subjektit dhe bashkëshortit, sikurse subjekti ka deklaruar, dhe për vitet 2009 – 2013 në këtë banesë ka qëndruar edhe motra e subjektit e cila vazhdon të studiojë në Tiranë. Ndërsa prindërit e bashkëshortit të subjektit, kanë punuar dhe banuar gjatë gjithë kohës në qytetin e Sarandës, në një apartament me sip. 97 m<sup>2</sup>, në pronësi të tyre, të blerë në vitin 1998.

v) Nuk ka pasur asnjë të dhënë nga asnjë burim i ligjshëm ashtu sikurse edhe nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ për lidhje të subjektit të rivlerësimit me pasurinë objekt shqyrtimi.

Për të gjitha këto arsye, Komisioni nuk ka kryer hetime të mëtejshme në lidhje me pasuritë, të ardhurat, detyrimet financiare, shpenzimet, etj., të prindërve të bashkëshortit të subjektit, me qëllim evidentimin e mundësisë së tyre financiare për blerjen e pasurisë.

---

*në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”*

<sup>11</sup> Data e pagesës së kësaj të parë të apartamentit prej 47,000 euro, nga ana e prindërve të bashkëshortit.



Në përfundim të hetimit administrativ, nuk u konstatuan problematika në lidhje me origjinën e pasurisë, si dhe nuk u evidentuan lidhje të subjektit me pasurinë, por subjekti nuk ka deklaruar të drejtat reale mbi këtë pasuri, konkretisht përdorimin e kësaj pasurie në DPDF 2009 – DPV 2017, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

Në parashtrimet e datës 10.2.2021, ashtu si edhe në seancën dëgjimore nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor, subjekti ka argumentuar mosdeklarimin e pasurisë si pasuri në përdorim, për shkak se, sipas saj:

*Së pari*, pasuria nuk i është dhënë asnjëherë në përdorim nga prindërit e bashkëshortit me ndonjë kontratë noteriale apo ndonjë akt tjetër, por ka banuar në këtë apartament në momentin kur është bërë pjesë e familjes Ahmeti..

*Së dyti*, në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 21.1.2017, prindërit e bashkëshortit kanë deklaruar: “Aktualisht në banesën tonë, me pëlqimin tonë, banon djali ynë shtetasi E. B. A. së bashku me bashkëshorten e tij shtetasen Alma T. Ahmeti dhe fëmijët e tyre E. A. dhe H. A.. Djali ynë dhe familja e tij jetojnë në këtë apartament me pëlqimin tonë, dhe pa ndonjë akt noterial pasi ne për shkak të marrëdhënieve të posaçme prind-fëmijë nuk pranojmë të lidhim ndonjë kontratë përdorimi”.

*Së treti*, duke qenë se në të gjitha deklaratimet periodike të pasurisë dhe deklaratën *Vetting*, ka deklaruar si adresë vendbanimi, të pasurisë “Rr. ‘\*\*\*’, p. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Kodi Postar \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë”, ka menduar se e ka ezauruar detyrimin për të deklaruar përdorimin e apartamentit.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni i vlerësoi bindëse dhe të arsyeshme pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe e çmoi mosdeklarimin e përdorimit të kësaj pasurie në deklaratat periodike vjetore, si një pasaktësi formale që nuk ka sjellë ndonjë pasojë, e cila është korrigjuar me deklaratën *Vetting* në të cilën subjekti ka deklaruar sipas ligjit përdorimin e kësaj pasurie.

#### **Në rubrikën detyrime financiare, subjekti ka deklaruar:**

1) Kredi për arsye personale familjare, me bashkëshortin në “Raiffeisen Bank”, fillimisht në datën 24.9.2012 në shumën 600,000 lekë, e përfshirë në vijim me kontratën në datën 25.9.2013 në shumën 1,000,000 lekë. Me kontratën përfundimtare nr. \*\*\*, datë 28.10.2015, është bërë ristrukturim i kredisë së mëparshme duke u mbyllur kredia e mëparshme e duke shtuar shumën e marrë kredi me vlerë përfundimtare 2,000,000 lekë me afat shlyerje 10 vjet<sup>12</sup> me interes 10.7%, me 96 këste, me vlerë kësti mujor 30,422.46 lekë. Detyrimi financiar i mbetur pa shlyer është në shumën 1,798,137 lekë.

Pas verifikimit të DPV, është konstatuar se kreditë janë deklaruar në DPV-të respektive për vitet 2012, 2013 dhe 2015. Ndërsa, pas verifikimeve në lidhje me këtë detyrim financiar, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

- Me kontratë kredie bankare datë 24.9.2012, shtetasit E. dhe Alma Ahmeti kanë marrë kredi në “Raiffeisen Bank”, në shumën 600,000 lekë, me qëllim për përdorim për arsye personale, me afat 60 muaj. Kjo kredi është deklaruar nga subjekti edhe në DPV-në e vitit 2012, duke deklaruar shumën e shlyer dhe gjendjen e detyrimit të mbetur. Pasi u pyet në lidhje me qëllimin dhe periudhën e përdorimit të kësaj kredie, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se kjo kredi është përdorur për mobilimin e banesës së prindërve ku jetonin, nga të cilat shuma

<sup>12</sup> I paqartë në deklaram, por që sipas kontratës është deri më 29.10.2023.

prej 250,000 lekësh për mobilimin e dhomës së ndenjes, shuma prej 200,000 lekësh për dritaret, grillat, dyert e ballkonit dhe pjesa e mbetur për tavolinë kompjuteri dhe bibliotekë.

- Me kontratë kredie bankare, datë 25.09.2013, shtetasit E. dhe Alma Ahmeti kanë marrë kredi në “Raiffeisen Bank”, në shumën 1,000,000 lekë, me qëllim për përdorim për arsye personale, me afat 84 muaj. Kjo kredi është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2013 dhe 2014, duke deklaruar gjithashtu shumën e shlyer dhe gjendjen e detyrimit të mbetur. Pasi u pyet në lidhje me qëllimin dhe periudhën e përdorimit të kësaj kredie, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se shuma e kredisë ka shkuar për pagimin e detyrimit të mbetur nga kredia e mëparshme në vlerën 586,667 lekë dhe pjesa tjetër është përdorur prej tyre, ku në vitin 2013 kanë shpenzuar përafërsisht shumën 200,000 lekë, për blerjen e disa pajisjeve elektroshtëpiake.

- Me kontratë kredie bankare, datë 28.10.2015, shtetasit E. dhe Alma Ahmeti kanë marrë kredi në “Raiffeisen Bank” në shumën 2,000,000 lekë, me qëllim përdorim për arsye personale, me afat 96 muaj. Kjo kredi është deklaruar nga subjekti edhe në DPV-të e viteve 2015, 2016 dhe 2017, duke deklaruar shumën e shlyer dhe gjendjen e detyrimit të mbetur. Pasi u pyet në lidhje me qëllimin dhe periudhën e përdorimit të kësaj kredie, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se shuma e kredisë ka shkuar për pagimin e detyrimit të mbetur nga kredia e mëparshme në vlerën 888,579 lekë dhe për mbylljen e *overdraft*-it të bashkëshortit në shumën 200,000 lekë. Shuma prej 900,000 lekësh, është shpenzuar për rikonstruksion dhe arredimin tërësor të banesës së prindërve të bashkëshortit. Sipas saj, në momentin e rikonstruksionit dhe mobilimit të apartamentit, asnjë send apo punim i veçantë nuk është në vlerën 300,000 lekë apo 2,500 euro, ose në një shumë më të lartë.

Siç vërehet, subjekti i ka deklaruar sipas ligjit kreditë e mara, shumat e shlyera dhe detyrimet financiare të mbetura deri në momentin që ka deklaruar shlyerjen totale të tyre.

Bazuar në shpjegimet e subjektit, shumat e kredive konsumatore janë konsideruar si shpenzime në analizën financiare sipas destinacionit të tyre: (i) për të shlyer kredinë e mëparshme; (ii) për mobilim dhe rikonstruksione të banesës ku jeton subjekti me familjen; (iii) pjesa e mbetur për shpenzime të tjera. Nga analiza financiare, konstatohet se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi financiare për shlyerjen e këtyre kredive, sikurse është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
Pasuri	-43 947	413 039	148 483	-94 161	183 768
Të ardhura	2 223 910	2 687 374	1 942 774	3 878 304	2 443 863
Shpenzime	1 440 545	1 942 830	1 470 456	3 358 306	1 578 315
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>827 312</b>	<b>331 505</b>	<b>323 835</b>	<b>614 159</b>	<b>681 781</b>

Për sa i takon kredisë në shumën 2,000,000 lekë marrë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2015 me maturim në vitin 2023, është shlyer tërësisht në vitin 2017, duke përdorur një kredi të marrë në “BKT” në datën 17.5.2017.

2) Kontratë *overdraft*, datë 23.5.2016, në emër të subjektit në “Tirana Bank”, me vlerë limit tërheqjeje 100,000 lekë dhe vlerë të përdorur 84,187.18 lekë, verifikuar gjatë hetimit administrativ me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2020, të “Tirana Bank”.

3) Kontratë e lidhur me shkollën “\*\*\*\*”, datë 7.7.2016, njëvjeçare, për fëmijën E. A. që ndjek studimet në klasën e parë, me pagesë 1,800 euro, paguar 800 euro. Vlera për t’u paguar 1,000 euro. Gjatë hetimit administrativ, ky deklarim i subjektit u vërtetua me aktet e vëna ne

dispozicion nga ILDKPKI-ja<sup>13</sup>, si vijojnë: (i) kontratë shkolle, datë 7.7.2016, me shkollën jopublike “\*\*\*\*”, ku rezulton se E. A. është nxënës në klasën e parë, me pagesë vjetore 1,800 euro; (ii) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2017, nga shkolla jopublike “\*\*\*\*”, ku vërtetohet se nxënësi i klasës së parë E. A. për vitin shkollor 2016 – 2017, ka kryer pagesën për këtë vit në shumën 800 euro.

**Pasuri të deklaruara nga personi i lidhur, z. E. A.**, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, i cili ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij, duke deklaruar:

1. Automjet me targa \*\*\*, marka \*\*\*, tipi \*\*\*, viti i prodhimit 2003, e blerë nga z. E. A. me kontratë nr. \*\*\*, datë 8.9.2016, paguar dogana, e regjistruar në DRSHTTRT. Vlera: 2,400 euro. Pjesa takuese: 100%. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni në lidhje me këtë pasuri**

#### **1.1 Në lidhje me mënyrën e përfitimit të këtij automjeti nga aktet në dosje<sup>14</sup> rezultoi se:**

- DPSHTTR-ja informoi se shtetasi E. B. A. ka pasur në pronësi automjetin me targa \*\*\*, të cilin e kishte blerë me kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*, datë 8.9.2016, nga shtetasi S. G., në vlerën 2,400 euro. Ky automjet është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit edhe në DPV-në e vitit 2016.

- Me kontratë shitje pasurie të luajtshme të datës 7.12.2017 (pas deklaratës *Vetting*), shtetasi E. A. e ka shitur këtë autoveturë, në shumën 2,200 euro.

#### **1.2 Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për blerjen e mjetit**

Duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi u pyet nga Komisioni, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, znj. Alma Ahmeti, ka dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me burimin që ka shërbyer për blerjen e këtij mjeti duke vënë në dispozicion kontrata shitje automjetesh me data të mëparshme ashtu sikurse dhe për burimet e krijimit të tyre me të ardhura të ligjshme.

Konkretisht, për automjetin objekt shqyrtimi, subjekti ka deklaruar se *burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit \*\*\*, me targa \*\*\*, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 13.7.2016, në vlerën 3,400 euro, shumë e cila ka qenë e depozituar në “Raiffeisen Bank”, në llogari të E. A.*

Pretendimet e subjektit vërtetohen me kontratë shitblerje pasurie të luajtshme Nr. \*\*\*, datë 13.7.2016, sipas të cilës shtetasi E. A. i ka shitur shtetasit A. D. mjetin e markës “\*\*\*\*” me targa \*\*\*, nr. shasie \*\*\*, në vlerën 3,400 euro. Pas verifikimit të llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank” të bashkëshortit të subjektit, u verifikua se shuma 3,400 euro është transferuar nga z. A. D. në datën 13.7.2016, me përshkrimin “*kalim për blerje makine*”. Kjo kontratë është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në DPV-në për vitin 2016 në rubrikën “*ndryshimet e pasurisë*”.

Automjeti i markës “\*\*\*\*” me targa \*\*\*, ishte blerë më parë nga bashkëshorti i subjektit me kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 25.10.2013, në vlerën 4,500 euro, deklaruar prej tij në DPV-në për vitin 2013. I pyetur për burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për të blerë këtë automjet, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se burimi i krijimit të kësaj

<sup>13</sup> Shihni aktet në aneksin 4/6 të dosjes së ILDKPKI-së.

<sup>14</sup> Shihni aktet në Aneksin 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së dhe aktet bashkëngjitur shkresës kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2020, nga DPSHTTRR në dosjen e Komisionit.

pasurie janë: (1) të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm tip “\*\*\*”, shitur me kontratë nr. \*\*\*, datë 14.9.2013, në vlerën 350,000 lekë; dhe (2) pjesa tjetër nga kursime familjare.

Në lidhje me burimin e parë të krijimit, Komisioni ka administruar kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 14.9.2013, sipas të cilës shtetasi E. A. i shet shtetasit A. S. automjetin tip “\*\*\*”, me targa \*\*\*, nr. shasie \*\*\*, në vlerën 350,000 lekë. Këtë automjet shtetasi E. A. e kishte blerë me kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 3.7.2013, nga shtetasi A. K. në vlerën 200,000 lekë. Këto dy kontrata të redaktuara brenda të njëjtit vit, nuk janë deklaruar në DPV-në për vitin 2013.

E pyetur mbi burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e automjetit në çmimin 200,000 lekë dhe arsyet e shitjes së mjetit pas rreth dy muajve në vlerën 350,000 lekë, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: “... burimi i krijimit të kësaj pasurie kanë qenë të ardhurat nga kursimet familjare nga puna dhe të depozituara në bankë ...”. Për sa i takon shitjes, pas dy muajsh në vlerën 350,000 lekë, ajo ka sqaruar se: “... automjeti ka qenë i përdorur dhe se janë bërë shpenzime për shkak të defekteve teknike që në muajin e parë të përdorimit, për afërsisht në vlerën 120,000 lekë. Nga shitja e këtij automjeti nuk është realizuar fitim, pasi automjeti është shitur sipas vlerës së blerjes duke i shtuar koston për shpenzimet e kryera. Automjeti është shitur për shkak të një okazioni, pasi kanë blerë një makinë më të mirë, automjetin \*\*\*, me targa \*\*\*, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 25.10.2013”, mjet i deklaruar në DPV-në për vitin 2013...”. Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentet shkresore si vijojnë:

- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 15.9.2020, e shtetasit A. K. i cili konfirmon deklaratimet e subjektit;
- kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 25.10.2013;
- kontratë shitje pasurie e luajtshme nr. \*\*\*, datë 14.9.2013;
- kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. \*\*\*, datë 3.7.2013.

Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë e blerjes së automjetit me kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 3.7.2013, duke llogaritur si shpenzim jo vetëm vlerën e blerjes prej 200,000 lekësh, por shumën 350,000 lekë, duke përfshirë shpenzimet për riparimin e tij, sipas deklaratimeve të subjektit. Për sa i takon burimit “kursime familjare”, në analizën financiare si në tabelën më poshtë, janë përfshirë të ardhurat nga pagat për periudhën 14.1.2013 – 3.7.2013<sup>15</sup>, të cilat janë në vlerën 831,330 lekë.

Përshkrimi	14.1.2013 – 3.7.2013
<b>Pasuri</b>	<b>140 052</b>
Automjet “***”, targa ***	350 000
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	<i>-209 948</i>
<b>Të ardhura</b>	<b>831 330</b>
Të ardhura nga pagat subjekti	418 800
Të ardhura nga pagat bashkëshorti	412 530
<b>Shpenzime</b>	<b>489 979</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	262 730
Shpenzime udhëtimi të brendshëm	131 901
Paguar/shlyer kredia	95 348

<sup>15</sup> Analiza fillon në këtë datë për të kuptuar mundësinë financiare vetëm për efekt të blerjes së automjetit dhe për të mos krijuar mbivendosije me një tjetër transaksion të kryer në datën 14.1.2013 nga bashkëshorti i subjektit, konkretisht depozitimin e shumës 2,400 euro në “Tirana Bank”, trajtuar në vijim, në rubrikën “konstatime të tjera, pika 8”.

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të blerë automjetin e tipit “\*\*\*\*”, në vlerën totale 350,000 lekë, dhe për këtë arsye shuma 350,000 lekë është përfshirë si burim për blerjen e automjetit tip “Audi” në datën 25.10.2013, në vlerën 4,500 euro.

Për sa i takon mundësisë financiare të subjektit për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, në shumën 4,500 euro në datën 25.10.2013, Komisioni ka kryer analizën financiare duke përfshirë si të ardhura të ligjshme: (i) të ardhurat nga shitja e automjetit tip “\*\*\*\*”, në shumën 350,000 lekë; (ii) të ardhurat nga pagat për periudhën e analizuar, të cilat janë në shumën prej 493,324 lekësh; si dhe (iii) kredia në vlerën 1,000,000 lekë nga “Raiffeisen Bank”, e cila është shpenzuar për mbylljen e kredisë së parë dhe mbetja për shpenzime të tjera.

Përshkrimi	03/07 deri 25.10.2013
<b>PASURI</b>	<b>648 631</b>
Blerë automjet tip “****”, targa ***	630 945
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	17 686
<b>TË ARDHURA</b>	<b>1 843 324</b>
Të ardhura nga pagat subjekti	285 512
Të ardhura nga pagat bashkëshorti	207 812
Kredi “Raiffeisen Bank”	1 000 000
Nga shitja e makinës	350 000
<b>SHPENZIME</b>	<b>966 139</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI <sup>16</sup>	176 183
Shpenzime arredimi etj. nga kredia e marrë	131 111
Shpenzime udhëtimi të brendshëm	88 452
Paguar/shlyer kredia	550 393
Shpenzime kredie	20 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>228 554</b>

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të blerë automjetin tip “\*\*\*\*”, në vlerën 4,500 euro.

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk rezultoi asnjë problematikë dhe dyshim në lidhje me automjetin e deklaruar nga bashkëshorti i subjektit me targa \*\*\*, blerë me të ardhura të ligjshme në datën 8.9.2016, në vlerën 2,400 euro. Për sa i takon mungesës së deklarimit të burimit të krijimit të këtij automjeti, sipas shtojcës nr. 2, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmon se për sa kohë u vërtetuan të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit, kjo pasaktësi nuk mund të konsiderohet si deklarim i pamjaftueshëm, në kuptim pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2106.

**2. Kredi sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 28.10.2015, është bërë te deklarimi i subjektit si bashkëkredimarrëse, në të njëjtin material (trajtuar më sipër).**

<sup>16</sup> Shpenzimet e jetesës janë llogaritur për katër persona, duke përfshirë edhe motrën e bashkëshortit e cila sikurse është deklaruar në pyetësorin nr. 2, ka jetuar me familjen e subjektit nga viti 2009 deri në 2013.

## KONSTATIME TË TJERA

Përveç sa është deklaruar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj në deklaratën *Vetting*, si më sipër, referuar të dhënave të deklaratave periodike vjetore apo të dhënave të konstatuara gjatë hetimit administrativ, Komisioni kreu disa verifikime të tjera, me qëllim një rivlerësim sa më objektiv dhe tërësor të kriterit të pasurisë, si vijon:

1. Duke qenë se nga subjekti dhe bashkëshorti, nuk janë deklaruar pasuri të paluajtshme në pronësi, me qëllim evidentimin e ndonjë pasurie në pronësi të tyre, nëpërmjet kërkesave drejtuar disa institucioneve ligjore, Komisioni ka administruar informacionet, si vijonë:

- ASHK-ja, drejtoritë vendore<sup>17</sup> të Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Tirana Jug, Tirana Veri dhe Kamëz-Vorë<sup>18</sup>, nuk kanë konfirmuar pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit.

- ASHK-ja<sup>19</sup> nuk ka konfirmuar ndërtime në proces legalizimi për shtetasit Alma T. Ahmeti dhe E. B. A..

- UKT-ja<sup>20</sup> nuk ka konfirmuar kontrata të furnizimit me energji në emër të shtetasve Alma T. Ahmeti dhe E. B. A..

- FSHU-ja<sup>21</sup> informoi për një abonent me gjeneralitete Alma Ahmeti kontratë furnizimi me Nr. \*\*\*, në instancën Gjirokastër. Pasi u pyet subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se nuk ka banuar asnjëherë në Gjirokastër dhe nuk ka lidhur asnjëherë ndonjë kontratë për furnizim me energji elektrike apo furnizimin me ujë. Subjekti ka vërtetuar pretendimet e saj me dokumentet shkresore si vijon:

- shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2020, nga FSHU-ja, sipas të cilës shtetasja me gjeneralitetet Alma T. Ahmeti (Zh.) nuk rezulton të jetë abonente dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike;

- shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2020, e Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sipas të cilës shtetasja Alma Ahmeti nuk ka kontratë të regjistruar në emrin e saj;

- vërtetime nga gjithë Ujësjiellës sh.a. të gjithë bashkive, përfshirë dhe UKT Gjirokastër sh.a, sipas të cilave Alma T. Ahmeti., mbiemri i vajzërisë Zh., nuk ka kontratë të lidhur me UKT.

2. Duke qenë se subjekti ka deklaruar se ka përdorur një apartament në pronësi të prindërve të bashkëshortit B. dhe D. A., nga viti 2009 dhe në vijim, dhe, për rrjedhojë, këta persona konsiderohen persona të tjerë të lidhur sipas përkufizimit në pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me këta persona u kryen disa verifikime, si vijon:

### 2.1. Me kërkesë të Komisionit:

- ASHK-ja, Tirana Jug<sup>22</sup>, konfirmoi pasurinë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në emër të shtetasit B. A. (pasuria e deklaruar nga subjekti).

<sup>17</sup> Shihni shkresat kthim-përgjigje nga ASHK vendore në dosjen e Komisionit.

<sup>18</sup> Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.11.2020, nga ASHK Tirana Rurale 1; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2020, nga ASHK-ja, Tirana Rurale 2; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2020, nga ASHK-ja, Tirana Jug; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2020, nga ASHK-ja Tirana-Veri; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2020, nga ASHK-ja, Kamëz- Vorë në dosjen e Komisionit.

<sup>19</sup> Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2020, nga ASHK-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>20</sup> Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2020, nga UKT-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>21</sup> Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2020, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>22</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2010, nga Tirana-Jug, në dosjen e Komisionit.

- ASHK-ja Sarandë<sup>23</sup>, konfirmoi të regjistruara në emër të shtetasve B. dhe D. A., pasuritë si vijojnë: (1) pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Sarandë; (2) pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Sarandë (pasuri e tjetërsuar); (3) pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Sarandë. Informacioni i vënë në dispozicion përputhet tërësisht me deklaratimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit (trajtuar në vijim).

-Të gjitha drejtoritë e tjera vendore të ASHK-së në Tirane dhe ato në rrethe, nuk evidentuan pasuri në pronësi apo në proces legalizimi në emër të shtetasve B. P. A. dhe D. A. A..<sup>24</sup>

- FSHU-ja informoi se shtetasi B. A. ka tetë kontrata të furnizimit me energji elektrike, tre nga të cilat ndodhen në Tiranë, përkatësisht në adresat, Rr. “\*\*\*\*”, Rr. “\*\*\*\*” (pasuria e deklaruar nga subjekti) dhe Rr. “\*\*\*\*”, ndërsa të tjerat ndodhen në qytetet Gjirokastrë (dy), Sarandë, Elbasan dhe Fier.

- UKT-ja<sup>25</sup>, nuk ka konfirmuar kontrata të furnizimit me energji në emër të shtetasve B. dhe D. A..

**2.2** Iu kërkuan sqarime subjektit në lidhje me informacionet e dërguara prej FSHU-së për tetë kontratat me abonentin B. A., dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, znj. Alma Ahmeti, deklaroi se vjehri i saj ka vetëm dy pasuri të paluajtshme në pronësi të tij, për të cilat ka lidhur kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe me ujë, përkatësisht: (1) apartament i ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*, pallati \*\*\*, Rruga nr. \*\*\*, \*\*\*, Sarandë, për të cilin ka lidhur kontratë furnizimi me energji elektrike nr. \*\*\* dhe kontratën me Ujësjetllës Kanalizime Sarandë me nr. \*\*\*; (2) apartament i ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, për të cilin ka lidhur kontratë furnizimi me energji elektrike nr. \*\*\* dhe kontratën e furnizimit me ujë, me Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë me nr. \*\*\*. Subjekti ka vërtetuar pretendimet e saj, me provat shkresore si vijon:

- deklaratë noteriale, datë 25.11.2020, të shtetasit B. A., i cili konfirmon deklaratimet e subjektit;  
- shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2020, të FSHU-së, sipas të cilës shtetasi me gjeneralitetet B. P. A. ka dy kontrata të furnizimit me energji elektrike me Nr. \*\*\* dhe \*\*\*, përkatësisht në Tiranë dhe në Sarandë;

- shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2020, në të cilën përcillen përgjigjet e shoqërive të Ujësjetllës Kanalizimeve në Shqipëri, nga të cilat vetëm UK Sarandë ka konfirmuar kontratë furnizimit për shtetasin B. A.;

- librezat e energjisë elektrike të lëshuara nga ish-Kesh sh.a., ish-CEZ Shpërndarje sh.a., si dhe librezat e lëshuar nga UKT për apartament me adresë Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, në emër të shtetasit B. A..

Gjithashtu, Komisioni verifikoi regjistrin *online* të gjendjes civile, ku rezultojnë të regjistruar 11 shtetas me emrin e vjehrit të subjektit, z. B. A., fakt që hedh dritë mbi pretendimet e subjektit.

**2.3** Me kërkesë të Komisionit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 shtesë, subjekti ka deklaruar se prindërit e bashkëshortit, shtetasit B. dhe D. A., përveç pasurisë së deklaruar në përdorim në Tiranë (trajtuar hollësisht në këtë vendim) dhe pasurisë apartament me sip. 97 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Sarandë, e blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 15.7.1998, kanë në

<sup>23</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2021, nga ASHK-ja Sarandë, në dosjen e Komisionit.

<sup>24</sup> Shihni shkresat kthim-përgjigje shkresës së Komisionit nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2020, nga drejtoritë vendore të ASHK në dosjen e Komisionit.

<sup>25</sup> Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2020, dosjen e Komisionit.





*kryer e për këtë arsye kjo shumë nuk është përdorur dhe i është kthyer dhe depozituar menjëherë në llogarinë e vëllait E. A.. Vëllai i bashkëshortit ka pasur mundësi për krijimin dhe dhënien e këtyre të ardhurave, pasi ka jetuar dhe ka qenë i punësuar në Bolonja, Itali ...”. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka vënë në dispozicion këto dokumente shkresore:*

- deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 19.12.2020, të shtetasve E. A. dhe E. A., të cilët konfirmojnë deklaratimet e subjektit;
- kopje epikrize të lëshuar nga spitali “\*\*\*”, Tiranë, që vërteton shtrimin në spital të pacientes D. A. në datën 22.3.2011 dhe dalje nga spitali më 23.3.2011;
- deklaratat e të ardhurave vjetore (CUD), për z. E. A. për vitet 2008 – 2013, të përkthyer, noterizuara dhe të legalizuara me vulë APOSTILLE<sup>32</sup>, sipas të cilave të ardhurat totale të z. E. A. nga viti 2008 deri në mars të 2011 janë në shumën 22,100 euro.

Pasi u pyet subjekti, në lidhje me mënyrën e dorëzimit të shumës 5,000 USD nga z. E. A., banues në Itali, bashkëshortit të saj, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, znj. Alma Ahmeti, deklaroi se shuma prej 5,000 USD është marrë me porosi të vëllait të bashkëshortit E. A. te shtëpia e prindërve të tij ku kjo shumë ka qenë në ruajtje dhe se shuma ka qenë e shtetasit E. A., i cili e ka sjellë atë në dhjetor 2010, kur ka ardhur me pushime në Shqipëri, fakt që u vërtetua me verifikimin në sistemin TIMS, ku rezultoi se shtetasi E. A. ka hyrë në Shqipëri në datën 23.12.2010 dhe ka dalë më 28.12.2010.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, rezultoi e vërtetuar se shuma 5,000 USD nuk i është dhënë hua bashkëshortit të subjektit, referuar fakteve si vijon: (i) kjo shumë është dhënë nga vëllai i bashkëshortit të subjektit për një afat prej dy ditësh dhe për efekt të një ndërhyrjeje kirurgjikale të nënës së tyre; (ii) kjo shumë është depozituar në bankë prej bashkëshortit të subjektit, i cili pas dy ditësh, në rrugë bankare i ka kthyer vëllait shumën, me përshkrime të sakta që vërtetojnë deklaratimet e subjektit; si dhe (iii) kjo shumë nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti si hua dhe as rezultoi të jetë përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie a shpenzimi prej subjektit dhe bashkëshortit. Për këto arsye, Komisioni nuk evidentoi lidhje të subjektit të rivlerësimit me shumën prej 5,000 USD, dhe as marrëdhënie interesi me vëllain e bashkëshortit, shtetasin E. A., të tilla, që do të bënin të domosdoshme hetime të mëtejshme.

**8.** Gjatë hetimit administrativ, referuar informacionit të marrë nga “Tirana Bank”<sup>33</sup>, ka rezultuar se në datën 14.1.2013, bashkëshorti i subjektit ka depozituar *cash* shumën prej 2,400 euro me përshkrimin “*hua*”. Pasi u pyet subjekti në lidhje me marrjen, qëllimin, kohën e kthimit të huas, si dhe arsyen e mosdeklarimit të saj në DPV-në e vitit 2013, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, znj. Alma Ahmeti deklaroi se: “... nga *statement* i llogarisë rezulton veprim “*depozitim në llogari*” dhe mendoj se shënimi hua është bërë gabim nga punonjësi i bankës. Unë dhe bashkëshorti im nuk kemi marrë e nuk i kemi dhënë hua asnjë personi. Në rast se kjo shumë do të ishte pagesë huaje do të depozitohej në llogari të bashkëshortit nga persona të tretë për shlyerje huaje ose do të depozitohej nga bashkëshorti për llogari të personave të tretë me përshkrimin për të shlyer hua. Shuma e depozituar është tërhequr përsëri nga bashkëshorti brenda vitit 2013. Burimi i krijimit të kësaj depozite ka qenë depozita ime, e cila është krijuar në ‘Raiffeisen Bank’ në datën 18.10.2011 dhe është tërhequr në korrik të vitit 2012, si dhe kursime nga të ardhurat nga pagat tona. Të ardhurat janë depozituar në llogarinë e bashkëshortit për të blerë makinë ...”.

Deklarimet e subjektit, u vërtetuan me të dhënat bankare të administruara, sipas të cilave, rezultoi se: (i) në datën 18.11.2011, subjekti ka çelur një depozitë në “Raiffeisen Bank” në

<sup>32</sup> Vënë në dispozicion në përgjigjet e subjektit të datës 13.1.2021.

<sup>33</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\*, datë 16.10.2020, nga “Tirana Bank” në dosjen e Komisionit.

vlerën 200,000 lekë, të cilën e ka deklaruar në DPV-në për vitin 2011; (ii) në datën 17.7.2012, subjekti ka tërhequr shumën prej 200,000 lekësh nga “Raiffeisen Bank”; dhe (ii) në datën 14.1.2013, bashkëshorti i subjektit ka derdhur në llogarinë e tij në “Tirana Bank”, shumën prej 2,400 euro, me përshkrim veprimi “hua”.

Si burim të ardhurash për krijimin e kësaj shume, sipas subjektit, përveç kursimeve familjare ka shërbyer dhe shuma prej 200,000 lekësh, e cila ishte mbajtur *cash* në shtëpi në vitin 2012, por që nuk ishte deklaruar në DPV-në për vitin 2012, me shpjegimin se “në DPV të vitit 2012 është harruar të deklarohet kjo shumë *cash* në fund të vitit, pasi është depozituar në llogari të bashkëshortit në janar 2013, ndërsa DVP-në për vitin 2012 është dorëzuar në mars të vitit 2013”.

Për sa i takon burimit të ligjshëm të depozitës prej 200.000 lekësh çelur në datën 18.11.2011 nga subjekti, nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank”, ka rezultuar se kjo depozitë është krijuar nga dy depozitime *cash* : shumës prej 150,000 lekësh në datën 11.10.2011 dhe shumës prej 50,000 lekësh në datën 18.10.2011. Lidhur me depozitimin e shumës prej 150,000 lekësh, duke ndjekur origjinën e saj, nga Komisioni është evidentuar se: (i) nga llogaria e bashkëshortit të subjektit të “Tirana Bank”, në datën 10.10.2011 është tërhequr shuma 150,000 lekë dhe vetëm një ditë më vonë e njëjta shumë është derdhur nga subjekti në llogarinë e saj, në “Raiffeisen Bank”; (ii) shuma prej 150,000 lekësh ishte depozituar fillimisht *cash* nga bashkëshorti të “Tirana Bank” në datën 26.7.2011. Për të vlerësuar mundësinë financiare për depozitimin e shumës 150,000 lekë në datën 26.7.2011, Komisioni ka kryer analizën pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën si vijon:

<b>Përshkrimi</b>	26.7.2011
<b>Pasuri neto</b>	<b>171 513</b>
Depozitim të “Tirana Bank”	150 000
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	21 513
Likuiditete/gjendje	-7 803
<b>Të ardhura</b>	<b>1 093 775</b>
Të ardhura nga pagat subjekti	431 799
Të ardhura nga pagat bashkëshorti	661 976
<b>Shpenzime</b>	<b>461 630</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	308 424
Shpenzime udhëtimi sipas TIMS	65 831
Shpenzime udhëtimi të brendshëm	52 800
Shpenzime shëndetësore	34 575
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>460 631</b>

Siç vërehet, duket se bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësi për depozitimin e shumës 150,000 lekë në datën 26.7.2011. Ndërsa, për sa i takon shumës prej 50,000 lekësh, të depozituar nga subjekti në “Raiffeisen Bank” në datën 18.10.2011, subjekti ka përdorur gjendjen *cash*, të mbartur që nga viti 2009<sup>34</sup>.

Pra, subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar depozitën në shumën prej 200,000 lekësh në “Raiffeisen Bank” në vitin 2011, sikurse është deklaruar prej saj në

<sup>34</sup> Trajtuar në pikën 10 te rubrika “Konstatime të tjera”.

DPV-në e këtij viti. Por pavarësisht kësaj, për shkak se subjekti nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën prej 200.000 lekësh (tërhequr në dt. 17.7.2012) në DPV-në për vitin 2012, sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, kjo shumë nuk është përfshirë si e ardhur ligjore për vitin 2012, i cili rezulton me një balancë negative prej -207.894 lekësh, pasqyruar në tabelën, si vijon:

<b>Përshkrimi</b>	<i>deri më 14.1.2013</i>
<b>Pasuri</b>	<b>230 529</b>
Depozituar te “Tirana Bank”	336 504
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	-105 975
Likuiditete/gjendje	-27 408
<b>Të ardhura</b>	<b>68 755</b>
Te ardhura nga pagat bashkëshorti	68 755
<b>Shpenzime</b>	<b>46 120</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	21 637
Shpenzime udhëtimi të brendshëm	10 862
Paguar/shlyer kredia	13 621
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-207 894</b>

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit si më sipër. Në parashtrimet e saj të datës 10.2.2021, subjekti ka pretenduar se shuma prej 200,000 lekësh, duhet të merret në konsideratë si e ardhur e ligjshme, pavarësisht mosdeklarimit të gjendjes *cash* në DPV-në për vitin 2012, duke sqaruar ashtu sikurse edhe gjatë procesit të rivlerësimit se, ky mosdeklarim ka qenë i lidhur me faktin se kjo shumë e mbajtur *cash* në banesë është depozituar në bankë në muajin janar dhe në kohën e plotësimit dhe deklarimit periodik vjetor në muajin mars të vitit pasardhës (2013), kjo gjendje *cash* nuk ishte më e disponueshme. Sipas saj, kjo pasaktësi lidhet me mospërputhjen në kohë të deklarimit dhe disponimit të shumës *cash*, por edhe të faktit të mos mbajtjes së një regjistrimi prej saj të gjendjes *cash* në banesë në fund të vitit për efekt deklarimi në ILDKPKI.

Pavarësisht se argumenti i përdorur nga subjekti në lidhje me mosdeklarimin e gjendjes *cash* në fund të vitit 2012, mund të jetë i vërtetë, është fakt që subjekti nuk ka deklaruar gjendjen *cash* prej 200,000 lekësh në këtë DPV, sipas detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003. Është e vërtetë se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të krijuar këtë shumë në vitin 2011, por deklarimi i *cash*-it për vitin 2012 do të përbënte provën që do të vërtetonte faktin se subjekti e ka pasur këtë likuiditet në momentin e depozitimit të shumës 2,400 euro prej bashkëshortit në datën 14.1.2013. Në këtë rast, kjo shumë do të konsiderohej si burim i ligjshëm në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës<sup>35</sup>.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi se analiza financiare për vitin 2012, mbetet me një balancë negative prej -207,894 lekësh, balancë e cila në proporcion me të gjitha rrethanat e çështjes, nuk përbën shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

<sup>35</sup> Referuar dhe qëndrimin të Kolegjit të Posaçëm të Apelimave shprehur në vendimet nr. 29/2019, datë 8.11.19; nr. 11/2019, datë 22.5.2019; nr. 19/2019, datë 26.7.2019; nr. 20/2019, datë 31.7.2019.

**9.** Referuar informacionit të marrë nga “Raiffeisen Bank”<sup>36</sup>, ka rezultuar se në datën 15.4.2013, në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit është kredituar shuma prej 5,500 euro me përshkrimin “*kalim fondi nga E. B. A.*”.

Pasi u pyet subjekti se çfarë përfaqëson kjo shumë dhe mbi burimin e ligjshëm për krijimin e saj, znj. Alma Ahmeti ka sqaruar se: “... kjo shumë është dërguar nga vëllai i bashkëshortit sepse ai kërkonte të hapte një biznes privat në Shqipëri. Shuma është tërhequr dhe i është dorëzuar babait B. A., për të realizuar investimin. Pas kryerjes së veprimeve paraprake, në datën 4.11.2013 është regjistruar subjekti ‘E. A.’, me NIPT \*\*\*. Vëllai i bashkëshortit ka pasur mundësi për kalimin e këtyre të ardhurave ...”. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka vënë në dispozicion këto dokumente:

- Statement bankar të bashkëshortit për llogarinë në euro “Raiffeisen Bank”, me të cilin vërtetohet kalimi i shumes 5,500 euro në llogari të bashkëshortit të subjektit nga vëllai i tij E. A. në datën 15.4.2013 dhe se kjo shume është tërhequr prej tij në tri pjesë: (i) shuma 3,000 euro në datën 2.5.2013; (ii) shuma 1,500 euro në datën 3.5.2013; dhe (iii) shuma 1,000 euro në datën 14.5.2013.

- Ekstrakt regjistrimi në QKB-së me datë 26.11.2020 në emër të subjektit person fizik E. A., me të cilin vërtetohet se ky subjekt është regjistruar në QKR në datën 4.11.2013, me NIPT \*\*\*, me fushë veprimtarie “farmaci veterinare”, sikurse është verifikuar edhe nga Komisioni në *website*-in e QKB-së.

- Deklaratat e të ardhurave vjetore CUD<sup>37</sup> për z. E. A. për vitet 2008 – 2013, të përkthyer, noterizuara dhe të legalizuara me vulë APOSTILLE, të cilat vërtetojnë të ardhura të shtetasit E. A. për periudhën prill 2011 – 15.4.2013, në shumën 31,617 euro.

- Kopje e pasaportës italiane të shtetasit E. A..

Bazuar në të gjitha provat si më sipër, rezultoi e vërtetuar se shuma 5,500 euro nuk i është dhënë hua bashkëshortit të subjektit, referuar fakteve si vijojnë: (i) kjo shumë është dërguar në rrugë bankare nga vëllai bashkëshortit të subjektit E. A. me një qëllim të caktuar, regjistrimin e personit fizik “E. A.” me NIPT \*\*\*, qëllim i cili rezultoi të jetë përmbushur; (ii) bashkëshorti i subjektit e ka tërhequr shumën në tri këste, në periudhën e kryerjes së procedurave të regjistrimit të personit fizik E. A. në QKR dhe përpara regjistrimit, fakt që tregon se shumata e tërhequra janë përdorur për efekt të këtij veprimi; (iii) kjo shumë nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti si hua dhe as rezultoi të jetë përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie a shpenzimi prej subjektit. Për këto arsye, Komisioni nuk evidentoi lidhje të subjektit të rivlerësimit me shumën prej 5,500 euro dhe as marrëdhënie interesi me të vëllanë e bashkëshortit, shtetasin E. A., të tilla, që do të bënin të domosdoshme kryerjen e hetimeve të mëtejshme.

**10.** Në lidhje me deklarimet e kursimeve *cash*, gjatë hetimit administrativ u evidentua se në deklaratën para fillimit të detyrës, subjekti ka deklaruar kursime *cash* në shumën 200,000 lekë, të akumuluar gjatë studimeve në Shkollën e Magjistraturës. Sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 14.10.16, të Shkollës së Magjistraturës rezultoi se bursa e përfutur nga subjekti për periudhën 1.10.2006 – 31.7.2008 ose 22 muaj, është 981,375 lekë. Referuar shpenzimeve të jetesës për të njëjtën periudhë në vlerën 243,704 lekë, duket se subjekti ka pasur mundësi të ketë fonde të

<sup>36</sup> Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\*, datë 30.10.2020, nga “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

<sup>37</sup> CUD është deklarimi vjetor i të ardhurave, i detyrueshëm për të gjithë shtetasit dhe rezidentët në Itali.

lira në shumën 737,671 lekë, shumë e cila e mbulon dhe e tejkalon shumën e kursyer prej 200,000 lekësh, deklaruar si e ardhur në deklaratën para fillimit të detyrës.

Në DPV-të në vijim, subjekti nuk përmend më shtime apo pakësime të gjendjes *cash*. Znj. Alma Ahmeti, pasi u pyet nëse dhe për çfarë është përdorur kjo shumë duke specifikuar edhe kohën/vitin përkatës, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se: “... *këtë shumë e kam shpenzuar përgjatë viteve 2010 – 2013, por nuk janë deklaruar pakësime pasi ka qenë pakësim i pjesshëm e në shuma të vogla dhe vëmendja ime ka qenë të pasqyroja shtesat mbi këtë shumë nëse do të kishte ...*”.

Në vijim, pasi iu kërkua të saktësonte shumat e pakësuara për çdo vit, subjekti ka sqaruar se<sup>38</sup> në DPFD 2009 është deklaruar gjendje *cash* shuma 200,000 lekë, por për shkak se ka kaluar një kohë e gjatë nuk e ka sigurinë të përcaktojë shumat e sakta të pakësuara çdo vit. Ajo deklaroi se shuma është konsumuar gradualisht në vitet 2010 – 2013 dhe ka shërbyer pjesërisht për: (i) shpenzimet e lindjes së djalit në vitin 2010; (ii) shpenzimet shëndetësore të fëmijës në vitin 2011; (iii) krijimin e depozitës në “Raiffeisen Bank”; dhe (iv) për rregullime të vogla në banesë.

Gjatë analizës financiare, gjendja *cash* prej 200,000 lekësh në fund të vitit 2009 është pakësuar përgjatë viteve 2010 – 2013<sup>39</sup>, bazuar në shpjegimet e mësipërme të subjektit.

**11.** Subjekti, në pyetësin standard, në përgjigje të pyetjes 12, deklaroi se në datën 29.5.2011, ka kryer një udhëtim në Athinë për arsye kontrolli shëndetësor për djalin E. A.. Pasi u pyet në lidhje me shpenzimet shëndetësore të kryera gjatë këtij udhëtimi, subjekti ka sqaruar se<sup>40</sup>: “.. *djali E. ka qenë i shtruar në Qendrën Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’ Tiranë gjatë periudhës 13 - 26.5.2011 dhe se pas daljes nga spitali ka pasur disa probleme shëndetësore. Për këtë arsye subjekti, bashkëshorti dhe djali kanë udhëtuar dhe qëndruar në Athinë te kushërira e subjektit, nga data 29.5.2011 deri më 11.6.2011. Shpenzimet spitalore janë në shumën 250 euro dhe janë shlyer tërësisht nga subjekti në datën e daljes nga spitali...*”

Subjekti, për të vërtetuar këto deklarime, ka vënë në dispozicion dokumentet shkresore, si vijojnë:

- kartelën e shtrimit, lëshuar nga spitali “\*\*\*”, ku vërtetohet qëndrimi në spital, diagnoza dhe terapia e kryer gjatë periudhës 13 – 26.5.2011;
- faturë origjinale të pagesës në shumën 249,43 euro, datë 3.6.2011, lëshuar nga spitali publik “\*\*\*” Athinë;
- deklaratë notoriale nr. \*\*\*, datë 12.8.2020, lëshuar nga shtetasit J. dhe K. P., të cilët deklarojnë se subjekti, bashkëshorti dhe djali i tyre kanë qëndruar në shtëpinë e tyre në Athinë dhe se kanë shpenzuar vetëm shpenzimet spitalore.

Bazuar në shpjegimet e subjektit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, Komisioni përfshiu si shpenzim në analizën financiare të subjektit për vitin 2011, shumën prej 249,43 euro. Shpenzimet ditore, gjatë qëndrimit të subjektit dhe familjes së saj në Athinë, janë përlllogaritur me 5 euro/dita sipas praktikës tashmë të konsoliduar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit<sup>41</sup>.

<sup>38</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes 4 të pyetësorit nr. 3, datë 21.12.2020.

<sup>39</sup> Për vitin 2010 është pakësuar shuma 50,000 lekë për shpenzime që lidhen me lindjen e djalit më 18.5.2010; për vitin 2011 është pakësuar shpenzimi shëndetësor 250 euro, i paguar në Greqi në datën 3.6.2011 dhe shuma 50,000 lekë depozituar te “Raiffeisen Bank”, në datën 18.10.2011; gjendja *cash* e mbetur është konsideruar si e përdorur në vlera të barabarta për secilin nga vitet 2012 dhe 2013.

<sup>40</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes 5, të pyetësorit nr. 3, datë 21.12.2020.

<sup>41</sup> Referuar vendimit nr. 11 (JR), datë 22.5.2019, të KPA-së.

12. Gjatë procesit të rivlerësimit, në të gjitha deklaratimet sa i takon vendbanimit, subjekti ka deklaruar se nga janari i vitit 2009 e në vijim ka banuar në shtëpinë e prindërve të bashkëshortit, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë. Ndërkohë, gjatë periudhës 2011 – 2015, subjekti ka kryer funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. Po kështu, bashkëshorti i saj ka punuar në Drejtorinë e Policisë Berat në periudhën 1.7.2007 – 12.4.2010, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit në periudhën maj 2010 – nëntor 2013, në Policinë Kukës në periudhën nëntor 2013 – mars 2014 dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë në periudhën prill 2014 – fund shkurti 2016.

Subjekti, pasi është pyetur se ku kanë banuar gjatë këtyre periudhave dhe i është kërkuar të deklarojë shpenzimet e qirasë apo të transportit në rast të udhëtimit nga banesa në punë e anasjelltas për secilin nga bashkëshortët, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 dhe pyetjeve shtesë të këtij pyetësori, ka deklaruar se nga janari i vitit 2009 e në vijim, ajo dhe familja e saj kanë banuar vetëm në Tiranë në Rr. “\*\*\*\*” dhe se nuk kanë banuar në asnjë adresë tjetër pasi kanë udhëtuar vajtje-ardhje nga banesa në punë, duke specifikuar në çdo rast mënyrën e udhëtimit dhe automjetet e përdorura për vete e bashkëshortin dhe duke dhënë shpjegime për periudhën e lejelindjes duke pretenduar të mos përlllogariten shpenzime transporti për këto periudha. Në analizën financiare, në rubrikën “shpenzime” janë përfshirë shpenzimet e transportit<sup>42</sup>.

13. Nga përgjigjet e pyetësorit standard dhe dokumentet shkresore të paraqitura bashkëngjitur u konstatua një kontratë bankare e datës 2.5.2017 me BKT-në, e nënshkruar nga bashkëshorti i subjektit në cilësinë e huamarrësit, ndërsa subjekti në cilësinë e garantueses, me objekt një kredi në shumën 1,800,000 lekë. Në aplikimin për kredinë, në seksionin “Informacion mbi pasuritë në pronësi”, subjekti dhe bashkëshorti kanë dhënë si informacion “Shtëpi banimi, Rr. ‘\*\*\*\*’, vlera e tregut 5,605,000 lekë”. Duke qenë se apartamenti me këtë adresë ka qenë në përdorim dhe jo pronësi të tyre, subjektit iu kërkuar sqarime dhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 shtesë, znj. Alma Ahmeti, ka sqaruar se banesa e ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” është deklaruar prej tyre vetëm si adresë banimi dhe jo pasuri në pronësi, pasi kjo ishte një kërkesë detyruese e bankës për efekt identifikimit e adresës së banimit, duke nënvizuar se nga ana e bankës nuk i janë kërkuar dokumentet e pronësisë, ashtu sikurse evidentohet edhe në dosjen e kredisë sipas kontratës së datës 12.5.2017.

### Analiza financiare

Gjatë hetimit administrativ, nga Njësia e Shërbimit Ligjor, është kryer një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, me qëllim evidentimin e justifikimit me të ardhura të ligjshme ose jo për pasuritë e shpenzimet, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, pasuritë, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet e detyrimet financiare, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën, si vijon:

	1	2	3	4	5	6
Përshkrimi	Pasuri	Detyrime	Pasuri <i>Neto</i> (1-2)	Të Ardhura	Shpenzime	Mundësia për Kursime (4-5-3)
2009	-51 259	0	-51 259	1 703 168	871 060	883 367
2010	21 943	0	21 943	1 576 825	568 939	985 944
2011	151 831	0	151 831	1 573 019	798 886	622 302

<sup>42</sup> Shihni rubrikën “metodologjia financiare”.

2012	-43 947	586 667	-630 614	1 623 910	1 427 212	827 312
2013	413 039	399 310	13 729	1 687 374	1 342 140	331 505
2014	148 483	-97 398	245 881	1 942 774	1 373 058	323 835
2015	-94 161	1 099 460	-1 193 621	1 878 304	2 457 766	614 159
2016	-447 177	-173 711	-273 467	1 983 945	1 575 631	681 781
<b>Total</b>	<b>98 750</b>	<b>1 814 329</b>	<b>-1 715 578</b>	<b>13 969 318</b>	<b>10 414 692</b>	<b>5 270 205</b>

## Metodologjia e përdorur

Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

### Të ardhurat

- Të ardhurat nga punësimi të dokumentuara të subjektit përfshirë: pagat duke filluar nga data 7.1.2009<sup>43</sup> dhe deri në fund të periudhës së vlerësimit; bursën në Shkollën e Magjistraturës për periudhën para emërimit në detyrë<sup>44</sup>.
- Të ardhurat nga punësimi të dokumentuara të bashkëshortit të subjektit, pagat nga punësimi<sup>45</sup> dhe çdo shpërblim tjetër i përfshirë në to.
- Të ardhurat nga interesat bankare<sup>46</sup>.
- Të ardhurat nga shitja e automjeteve sipas kontratave të shitblerjeve përkatëse.

### Shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur bazuar në standardin e ILDKPKI-së<sup>47</sup> dhe sipas përbërjes familjare<sup>48</sup> të subjektit të rivlerësimit.
- Shpenzimet e shkollimit<sup>49</sup> të djalit të subjektit.
- Shpenzimet e udhëtimit dhe pushimeve, për të cilat është konsideruar raporti nga sistemi *TIMS* dhe sqarimet e dhëna nga subjekti në pyetësin standard. Metodologjia e përlllogaritjes

<sup>43</sup>Vërtetim page si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 7.1.2009 - 30.6.2010; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 18.10. 2016, nga Gjykata e Lartë për pagën gjatë periudhës 8.6.2015 - 21.4.2016; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2016, nga Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore Kukës për lejen e lindjes për periudhën 18.5.2010 – 18.5.2011 dhe tetor 2014 – 8.6.2015; vërtetim nr. \*\*\*, datë 24.1.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës për pagesat e orëve jashtë orarit dhe shpërblime.

<sup>44</sup> Vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2016 paga si magjistrate në vitet 2006 - 2008.

<sup>45</sup> Vërtetim datë 1.7.2007 - 12.4.2010, nga ISSH-ja Drejtoria Vendore e Policisë Berat; vërtetim për periudhën maj 2010-nëntor 2013 (paga dhe shpërblime), nga ISSH-ja me punëdhënëse Drejtoria e Policisë së Shtetit; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2016, nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës për pagën gjatë periudhës 6.11.2013 - 31.3.2014; vërtetim nr. \*\*\*, datë 12.10.2016, nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë për pagën gjatë periudhës 4/2014 – 2/2016; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2016; vërtetim për periudhën 1.3.2016 – 31.12.2016, nga ISSH-ja me punëdhënëse Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë.

<sup>46</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>47</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2019, nga ILDKPKI-ja.

<sup>48</sup> Përbërja familjare për efekt të përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve është ndarë në këto periudha: viti 2009 tre persona (motra e bashkëshortit përfshirë periudhën 2009 – 2013); 2010 – 2013 janë 4 persona sepse lind djalë më 18.5.2010; viti 2014 tre persona deri në fund të nëntorit, sepse ikën motra e bashkëshortit dhe lind vajza më 29.11.2014; për vitet 2015 dhe 2016 katër persona.

<sup>49</sup> Kontratë datë 7.7.2016 me shkollën “V. H.”; vërtetim nga shkolla “V. H.” nr. \*\*\*, datë 26.1.2017; DPV/2015-2016.

së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, të datës 22.5.2019, të KPA-së.

- Shpenzimet e udhëtimit të brendshëm gjatë vajtje-ardhjes nga vendbanesa në vendin e punës janë vlerësuar bazuar në deklaratimet e subjektit gjatë përgjigjes së pyetësorëve. Metodologjia e përdorur në përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve është bazuar në shpjegimet e subjektit, si dhe në verifikimet e kryera në lidhje me çmimin e biletave dhe karburantit, konkretisht: 1 muaj është konsideruar me 22 ditë pune; çmimi i biletës Tiranë-Kukës-Tiranë dhe Tiranë-Berat-Tiranë 800 lekë përkatësisht; Tiranë-Korçë-Tiranë 1,000 lekë; çmimi i karburantit kur është përdorur automjeti personal për në Kukës është vlerësuar me 4,000 lekë për një rrugë vajtje-ardhje<sup>50</sup>. Meqenëse subjekti nuk ka dhënë përcaktime numerike të qarta për udhëtimet kur kanë qenë të dy bashkëshortët në Kukës, është konsideruar se kanë udhëtuar me automjetin personal për 18 ditë nga muaji nëntor 2013 dhe 1 muaj gjatë vitit 2014<sup>51</sup>. Nga këto shpenzime nuk janë përjashtuar ditët kur është udhëtuar me kolegë dhe ditët kur bashkëshorti ka qëndruar edhe natën në ambientet e institucionit ku ka punuar, pasi subjekti nuk ka deklaruar ditë konkrete. Nuk janë përlllogaritur shpenzime udhëtimit të brendshme kur subjekti ka punuar dhe qëndruar në Tiranë.

- Shpenzime arredimi/rinovimi janë konsideruar shumat e mbetura nga kreditë personale në “Raiffeisen Bank”, pasi janë shlyer tërësisht kredia/të e mëparshme (për vitet 2012, 2013 dhe 2015). Për vitin 2009, sikurse është deklaruar nga subjekti në pyetësorët e përgjigjur gjatë hetimit administrativ.

- Shpenzime të tjera sikurse janë evidentuar nga mandatpagesa apo fatura si pagesat e primeve të sigurimit, shpenzimet e sigurimit të jetesës gjatë marrjes së kredive në “Raiffeisen Bank”, shpenzime shëndetësore.

### **Pasuritë**

- Përfshihen të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi dhe bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortit.

- Likuiditetet trajtohen si pjesë e pasurive, në një zë të veçantë. Gjendjet e llogarive bankare<sup>52</sup> në fund të çdo viti/date të analizuar dhe gjendjet *cash* sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të dhe sqarimet e dhëna në përgjigje të pyetësorëve gjatë procesit të rivlerësimit.

- Secila nga pasuritë është analizuar në kohën e krijimit të saj. Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për një vit të caktuar ushtrimor.

- Vlera e çdo pasurie është marrë nga kontratat e shitblerjeve, deklaratat noteriale, si dhe çdo provë tjetër e administruar nga Komisioni, e ballafaquar me deklaratën *Vetting* dhe DPV-të.

- Çdo pronë është regjistruar në atë datë/vit kur është paguar.

Shuma në fund përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti nga fillimi i detyrës deri në krijimin e pasurisë së fundit.

### **Detyrimet**

Kreditë e marra nga subjekti dhe bashkëshorti në “Raiffeisen Bank” janë marrë sipas kontratave të nënshkruara me bankën.

---

50 Distanca x 7 litra/100 km x çmimi mesatar i karburantit për atë vit.

51 Bashkëshorti ka punuar në Kukës në periudhën 6.11.2013 – 31.3.2014.

52 Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2020, nga “Raiffeisen Bank”; shkresa nr. \*\*\*, datë 16.10.2020, nga “Tirana Bank”.



Shtim i detyrimit konsiderohet marrja e kredisë (pasqyruar me +).

Pakësim i detyrimit, pagesat e principalit të kredisë (pasqyruar me -); ndërsa pagesat e interesave janë të pasqyruara te shpenzimet.

Pasuria *neto* është diferenca e pasurisë me detyrimet (III-IV).

**Rezultati financiar** është i përlogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total.

- Mundësia për kursime rezulton si shumatore e të ardhura – (*shpenzime + pasuri neto*).
- Mundësia financiare analizohet për çdo pasuri të krijuar, në momentin e pagesës për pasurinë.
- Mundësia financiare analizohet për çdo vit kalendarik.
- Pamundësia financiare totale është shumatorja e viteve me rezultat negativ (-).

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Alma T. Ahmeti, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.11.2017, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në Deklaratën për Kontrollin e Figurës; (ii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e saj apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Alma T. Ahmeti.

### **Hetimi i Komisionit**

Me kërkesë të Komisionit për përditësim të dhënash, DSIK-ja<sup>53</sup> ka informuar se Grupi i Punës ka kryer përditësim informacioni për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, duke vënë në dispozicion një shkresë konfidenciale me informacion në lidhje me subjektin e rivlerësimit. Me qëllim vërtetimit të këtij informacioni, si dhe evidentimit dhe verifikimit të çfarëdo informacioni tjetër në lidhje me subjektin Alma Ahmeti, nga Komisioni u ndërmeren hapat hetimore si vijojnë:

- DSIK-së iu kërkua të verifikonte informacionin e ardhur nga organet ligjzbatuese në lidhje me subjektin e rivlerësimit, si dhe të përditësonte çdo informacion të ri në lidhje me këtë subjekt, duke i kërkuar të rishikonte raportin dhe nëse do të kishte vend të bënte ndryshimin e konstatimit fillestar. Me shkresë konfidenciale, DSIK-ja ka informuar se pas verifikimeve, Grupi i Punës konfirmon konstatimin fillestar për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës nga subjekti.
- Trupi gjykues verifikoi pranë organeve ligjzbatuese të gjitha informacionet për subjektin e rivlerësimit.

<sup>53</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2020, nga DSIK-ja në dosjen e Komisionit.

- Subjektit të rivlerësimit iu kërkuan sqarime në lidhje me vendimmarrjen në ngarkim të një shtetasi (trajtuar hollësisht në rubrikën “rivlerësimi profesional”).

- SPAK-ut iu kërkua informacion në lidhje me përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar të personave me të cilët subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur kontakte dhe në përfundim të procesit të rivlerësimit nuk kanë rezultuar të dhëna.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, nga Komisioni nuk u evidentuan fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës pranë DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma T. Ahmeti, është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

### **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, bazuar në:

**C/1.** Raportin për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor, dërguar me shkresën nr. 1292/4 prot., datë 12.10.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2020, nga ku rezultuan gjetjet si vijojnë:

#### **1. Për aftësitë profesionale**

##### *a) Njohuritë ligjore*

Gjyqtare Alma Ahmeti ka aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Ajo, përgjithësisht, identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj, si dhe përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës. Në funksion të zbatimit të ligjit gjyqtarja përdor referenca në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë.

##### *b) Për arsyetimin ligjor*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Nga pikëpamja formale, vendimet përfundimtare të saj plotësojnë sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penal apo kërkesat e legjislacionit procedural civil. Ndërsa në lidhje me dokumentin ligjor relacion të përzgjedhur në Gjykatën e Lartë, rezulton se ky i fundit është formal. Nuk ka asnjë mendim nëse plotësohen ose jo shkaqet për rekurs sipas parashikimeve të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, si dhe nuk gjen pasqyrim asnjë argument ligjor me rëndësi për marrjen e vendimit si në aspektin e ligjit material ashtu dhe atë procedural.

Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet rregullisht për shpenzimet procedurale apo gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët. Gjithashtu, te të katërta dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, ndërsa disponon me vendim mbi çdo kërkesë të palëve ndërgjyqëse.

#### **2. Për aftësitë organizative**

##### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.6.2015 dhe 20.4.2016-8.10.2016 (përafërsisht 2 vjet dhe 2 muaj) znj. Alma Ahmeti ka përfunduar gjithsej 248 çështje gjyqësore, nga të cilat 168 çështje penale (51 çështje themeli dhe 96 masa sigurimi dhe administrativo-penale) dhe 80 çështje

civile (30 çështje familjare dhe 50 çështje civile të përgjithshme). Sipas germës “g”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit konstatohet se ngarkesa sasiore e subjektit Alma Ahmeti, ka qenë nën standardin sasior.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Lartë konstatohet se për periudhën e rivlerësimit, 2.6.2015 - 20.4.2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, në detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë ka relatuar 182 dosje, nga të cilat 167 janë relacione që përmbajnë emrin e saj dhe 15 dosje pa emrin e saj. Në analizën e këtyre të dhënave duhen evidentuar tre faktorë: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar numrin e çështjeve për relativim që i janë caktuar dhe, rrjedhimisht, rendimenti i punës së saj nuk mund të përcaktohet; (ii) kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës së Lartë; (iii) mungesa e të dhënave mbi kohën e caktimit të çështjeve për relativim dhe e datës së përfundimit të relacionit nga ndihmësja ligjore bën të pamundur llogaritjen e kohëzgjatjes së relacionit të përzgjedhur me short për vlerësim.

Ndër 4 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në asnjë rast nuk është konstatuar tejkalimi i afatit standard të gjykimit të vendosur nga ligji apo KLD-ja në Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve. Nga analiza e tri dokumenteve është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë brenda afateve standarde të përcaktuara nga Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, shfaq aftësi për të përfunduar në kohë gjykimet e caktuara, që është tregues i lidhur me aftësitë për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim. Një tipar i mirë i punës së saj është vënia në lëvizje e çështjes pa vonesa përmes vendimeve formale për regjistrimin e kërkesëpadisë dhe caktimin e seancës përgatitore. Veprimet përgatitore të kryera janë dokumentuar me procesverbale të rregullta nga pikëpamja formale.

Gjatë gjykimit, gjyqtarja Alma Ahmeti identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe zhvillon siç duhet procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve, njohjen për çdo rast me të drejtat dhe detyrimet procedurale, prezantimin e gjykatës, debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në shpalljen e vendimit.

#### *c) Aftësia për të administruar dosjet*

Për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, është konstatuar se përgjithësisht aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në të pesta dosjet gjyqësore nuk janë evidentuar problematika lidhur me administrimin e akteve, ndërkohë që, në një rast që i përket periudhës së ushtrimit të detyrës së ndihmësligjorit pranë Gjykatës së Lartë, rezultoi se mendimi i ndihmësligjorit nuk është i përfshirë në dosjet fizike përkatëse. Nga ana tjetër, në dokumentin relacion nuk identifikohet koha e përpilimit të tij, pasi aktet nuk kanë datë dhe nënshkrim të subjektit të rivlerësimit.

### 3. Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

#### *a) Etika në punë*

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezultoi se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Alma Zhupa (Ahmeti) nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së.

#### *b) Integriteti*

Për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

*c) Paanësia*

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti. Asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhen me çështje të tjera të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore, të pakicave apo të të miturve. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Gjyqtarja i ka garantuar palëve të drejtën e përfaqësimit apo të mbrojtjes me avokat.

4. Për aftësitë personale dhe angazhimi profesional

*a) Aftësitë e komunikimit*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore dhe gjyqësore, ku shfaq sjellje profesionale dhe etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Nga të dhënat e regjistrave të ankesave nuk rezultojnë të jenë paraqitur ankesa për shkelje të etikës gjyqësore apo që lidhen me komunikimin e gjyqtarës.

*b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Nuk evidentohen të dhëna të drejtpërdrejta mbi aftësinë e gjyqtarës Alma Ahmeti për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore. Në relacionin e vëzhguar nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

*c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

Për shkak të funksionit që kryen, subjekti i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 17 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe është certifikuar në 16 prej tyre (në një ka marrë pjesë pjesërisht). Këto të dhëna tregojnë se subjekti ka marrë pjesë në 26 ditë trajnimi gjithsej. Lënda e trajnimeve ku ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë.

**C/2** Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:

**1.** Informacioni i marrë nga tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave prej Komisionit rezultuan gjetje të evidentuara edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në raportin e tij, si vijojnë:

Së pari, gjatë procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, nga verifikimi i akteve të dosjes nr. 2, që i përket çështjes civile nr. \*\*\* regj. them., datë 12.7.2013, me palë ndërgjyqëse paditës Q. G., kundër palës së paditur C. Sh., Shërbimi Përmbarimor Z., A. N., me objekt të padisë “Konstatim pavlefshmërie absolute të titullit ekzekutiv”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.12.2013, nga analizimi i akteve u konstatua se: (i) kundër vendimit është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.10.2014 ka vendosur “*Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 2.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe rrëzimin e kërkesëpadisë*” dhe se shkak i cenimit të vendimit është interpretim i gabuar i ligjit dhe i provave; (ii) në dosje mungon akti për shortimin e çështjes, ndërsa në kapak të dosjes ka

shënim për kalimin e dosjes te gjyqtarja Alma Ahmeti; (iii) në aktet e vëna në dispozicion nuk ndodhen kërkesëpadia dhe provat përkatëse.

Së dyti, në lidhje me dokumentin ligjor relacion të përzgjedhur në Gjykatën e Lartë, nga analizimi i tij, siç evidentohet edhe në raportin e KLGj-së, u konstatua se ky i fundit është formal, nuk ka asnjë mendim nëse plotësohen ose jo shkaqet për rekurs sipas parashikimeve të nenit 58 të ligjit 49/2012, si dhe nuk gjen pasqyrim asnjë argument ligjor me rëndësi për marrjen e vendimit si në aspektin e ligjit material ashtu dhe atë procedural.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me këto konstatime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

*Së pari*, në parashtrimet e saj, lidhur me ndryshimin e vendimit të saj nga Gjykata e Apelit me arsyetimin se vendimi është dhënë në interpretim të gabuar të ligjit dhe të provave, subjekti ka sqaruar se në cilësinë e gjyqtarës, për të njëjtën kategori çështjesh, në të njëjtën situatë faktike dhe ligjore ka disponuar në të njëjtën mënyrë, ndërsa sipas saj ka qenë Gjykata e Apelit Shkodër që ka ndryshuar praktikë, duke i pranuar këto kategori padish.

Subjekti, për të mbështetur argumentet e saj, ka referuar dy vendime të tjera të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Konkretisht, janë vënë në dispozicion:

1) Vendimi nr. \*\*\*, datë 28.12.2017, me paditës T. M. e paditur O., me të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë së paditësit T. M.. Saktësimin e detyrimit të paditësit ndaj palës së paditur O. sh.a. në shumën respektive të titujve ekzekutiv të faturave të energjisë elektrike për muajt prill 2007, mars 2008, maj 2008, korrik 2008, shtator 2008, tetor 2008, nëntor 2008 dhe dhjetor 2008. Pavlefshmërinë e pjeshme të titujve ekzekutivë fatura të konsumit të energjisë elektrike vetëm për sa i përket emrit të abonentit T. M., për faturat janar 2009 - dhjetor 2013, për shkak se detyrimi nuk ekziston në ngarkim të paditësit T. M.”*. Në lidhje me këtë vendim, subjekti ka deklaruar se është ankimuar në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.2.2018, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 28.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës”*.

2) Vendimi nr. \*\*\*, datë 13.2.2017, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë së paditësit Z. E.. Konstatimin e pavlefshëm të faturave të energjisë elektrike titujve ekzekutiv, për sa i takon kontratës nr. \*\*\*, në emër të paditësit Z. E. për periudhën janar 2007 – prill 2014”*. Në lidhje me këtë vendim, subjekti ka deklaruar se është ankimuar në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me vendimin nr. \*\*\* datë 16.4.2018 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 13.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës”*.

Për sa është parashtruar më sipër, lidhur me ndryshimin e vendimmarrjes së saj nga Gjykata e Apelit Shkodër, përpos argumenteve bindëse të subjektit, Komisioni vlerëson se vendimmarrja i përket bindjes së brendshme të gjyqtarit, e cila është objekt gjykimi në shkallët më të larta të gjyqësorit, dhe në këtë kuptim nuk e konsideron ndryshimin e vendimit të subjektit nga Gjykata e Apelit Shkodër, si një të metë të aftësive profesionale të saj.

*Së dyti*, për sa i takon konstatimit për vendosjen e shënimit mbi kapakun e dosjes lidhur me kalimin e çështjes te gjyqtari, ndërkohë që nuk dokumentohet shortimi i çështjes, subjekti ka sqaruar se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës prej vitit 2015 është instaluar sistemi elektronik i shortit dhe regjistrimi *audio*. Për periudhën para vitit 2015, shorti organizohet manualisht nga kryetari i gjykatës në prani të të gjithë gjyqtarëve dhe pasqyrohet në librin e protokollit, duke u bërë shënimi nga kryetari në kapakun e dosjes për datën e shortit dhe emrin

e gjyqtarit. Ndërsa, në lidhje me konstatimin se gjykata nuk ka vënë në dispozicion kërkesëpadinë dhe provat përkatëse, subjekti ka sqaruar se kopjet e dosjeve për efekt të procedurës së rivlerësimit kalimtar nga KLGj-ja, janë kërkuar në kancelarinë e gjykatës dhe nuk ka dijeni për mënyrën se si është proceduar nga kancelaria për dërgimin e kopjeve të dosjeve.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi bindëse sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk konstatoi mangësi që cenon aftësitë profesionale të saj.

*Së treti*, lidhur me gjetjet në dokumentin relacion të përpiluar prej saj, subjekti ka sqaruar se në periudhën 8.6.2015 - 20.4.2016, kur ka shërbyer si ndihmësligjore në Gjykatën e Lartë, nuk ka pasur ndonjë rregullore të brendshme apo praktikë të unifikuar mbi mënyrën e përpilimit të relacioneve. Në këto kushte, relacionet përpiloheshin sipas një modeli të përcaktuar nga gjyqtari pranë të cilit ishin caktuar ndihmësit. Sipas saj, në relacion nuk mund të përcaktohej zgjidhja konkrete për lënien në fuqi apo prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta, pasi vendimmarrja është atribut vetëm i trupit gjykues dhe jo i ndihmësligjorit. Sa i takon konstatimit se mendimi i ndihmësligjorit nuk është i përfshirë në dosjen fizike përkatëse, subjekti ka sqaruar se relacionet e përpiluara dërgoheshin në sistemin elektronik të gjykatës dhe në përfundimin e gjykimit dërgoheshin në sekretari për t'u lidhur.

Pavarësisht argumenteve të paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se, edhe pse subjekti në cilësinë e ndihmësligjores nuk ka pasur funksion vendimmarrës, ajo mund të jepte një opinion ligjor më të plotë lidhur me zgjidhjen e çështjes. Por, në konsideratë të faktit që subjekti ka ushtruar detyrën si ndihmëse në këtë gjykatë për një periudhë të shkurtër (10 muaj), në vlerësimin tërësor të aftësive profesionale, si dhe në respekt të parimit të proporcionalitetit, ky fakt nuk cenon aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**2. Informacioni i marrë nga 5 denoncime nga publiku të administruara nga Komisioni.**

**2.1 Denoncim nga shtetasit M.D. dhe I. D.<sup>54</sup>**

Në denoncimin e tyre, këta shtetas ngrinin pretendime për hetime jo të plota dhe të pavarura të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe vendimmarrje arbitrare në favor të të pandehurit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, pasi sipas tyre, në të gjithë arsyetimin e vendimit nuk pasqyrohej e vërteta faktike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se shtetasit M. D. dhe I. D. kanë kallëzuar penalisht në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës shtetasin S. D. etj., për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës ka regjistruar procedimin penal, të cilin më pas e ka dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës për gjykim. Kjo gjykatë (gjyqtarja Alma Ahmeti) ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit S. D. për veprën penale “ndërtimi i paligjshëm” nëpërmjet vendimit nr. \*\*\*, datë 4.2.2020.

Në përfundim të hetimit administrativ u vlerësua se pretendimi i denoncuesit për vendimmarrje arbitrare në favor të të pandehurit nuk qëndronte, pasi gjyqtarja Alma Ahmeti ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit S. D. për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”. Për sa pretendohet nga denoncuesi në lidhje me mospasqyrimin e të vërtetës në pjesën arsyetuese të vendimit, vlerësohet se këto pretendime lidhen thelbësisht me vendimmarrjen e gjyqtarës dhe janë objekt gjykimi nga një gjykatë më e lartë nëpërmjet të drejtës së ankimit të vendimit.

---

<sup>54</sup>Shihni denoncimin nga shtetasit M. D., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020, në dosjen e Komisionit.

## 2.2 Denoncim nga shtetasi A. I.<sup>55</sup>

Në denoncimin e tij, ky shtetas denoncon prokurorët e Prokurorisë së Kukësit, E. K., R. Gj., si dhe gjyqtarët e Rrethit Gjyqësor Kukës, Alma Ahmeti dhe F. V.. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, ai ngre pretendime se ka bashkëpunuar me subjektet e tjera, por pa përcaktuar ndonjë shkelje ligjore konkrete.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur denoncimit u konstatua se shtetasi A. I. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës me ankim kundër vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal” datë 31.5.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Prokurori ka arsyetuar në vendim se denoncuesi A. I. ka pretendime në lidhje me regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, tokë e përmbytur, duke konkluduar se bëhet fjalë për marrëdhënie juridiko-civile administrative që zgjidhen në rrugë administrative ose në gjykatë dhe jo me ndonjë fakt kriminal. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, shtetasi A. I., i cili ngrinte pretendime për falsifikim dokumentesh për të akuzuarit, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ku gjyqtarja Alma Ahmeti ka vendosur: (i) pranimin e kërkesës së kërkuarit A. I. dhe prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 31.5.2017; (ii) urdhërimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës për regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve për të përcaktuar nëse ka elementë të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve.

Në përfundim të hetimit administrativ, nga Komisioni nuk u konstatuan shkaqe apo rrethana që tregojnë veprime të njëanshme apo bashkëpunime të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, me subjektet e tjera siç pretendohet, pasi ajo ka marrë vendim të ndryshëm nga Prokuroria, duke e kthyer çështjen për hetime në Prokurori.

## 2.3 Denoncim nga shtetasi B. H.<sup>56</sup>

Në denoncimin e tij, shtetasi B. H. pretendon se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, ka kryer një sërë shkeljesh në procesin gjyqësor që nëna e tij K. H. ka hapur kundër një personi për cenim, zaptim dhe shfrytëzim të pronave të saj për rreth 3 vjet.

*Së pari*, denoncuesi ngrinte pretendime se gjyqtarja ka ndryshuar/tjetërsuar aktekspertimin e paraqitur në gjykatë nga eksperti topograf; në vendimin e gjykatës, f. 7, pika 17, në paragrafin 3 gjyqtarja aktin e ekspertizës të ndryshuar prej saj e përdor si kusht të paplotësuar bazuar në nenin 302<sup>57</sup> të Kodit Civil; eksperti, në aktekspertimin të dorëzuar pranë gjykatës në kërkesën nr. 2 të dhënë nga gjykata, thotë të kundërtën e asaj që gjyqtarja përdor si kusht të paplotësuar.

Për sa i takon këtij pretendimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur bashkëngjitur denoncimit, konkretisht, referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 21.3.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës (gjyqtare Alma Ahmeti), f. \*\*\*, pika \*\*\*, paragrafi \*\*\*, u konstatua se, sipas nenit 302 të Kodit Civil, mbi përmbushjen e kushteve të padisë mohuese, midis të tjerave subjekti ka parashtruar se “... *pavarësisht se paditësi është pronar i sendit, si dhe pavarësisht se i padituri nuk ka asnjë të drejtë mbi këtë send, i padituri me veprimet e tij e cenon paditësin në mënyrë të paligjshme në pronësinë e sendit të tij. Nga aktekspertimi i paraqitur nga eksperti në seancën gjyqësore të datës 21.3.2018 provohet se sipërfaqja e pronësisë që i përket paditësit nuk është tërësisht e lirë në përdorimin e paditëses. Por disa parcela janë në përdorim nga*

<sup>55</sup> Shihni denoncimin nga shtetasi A. I., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2020, në dosjen e Komisionit.

<sup>56</sup> Shihni denoncimin nga shtetasi B. H., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 25.5.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>57</sup> Pronari ka të drejtë të kërkojë nga cilido që e cenon në pronësinë e tij, por pa u zhveshur nga posedimi, të pushojë cenimin dhe të mos përsërisë këtë në të ardhmen dhe kur është rasti të shpërblejë dëmet që mund t'i ketë shkaktuar.

*shtetasit A. R. dhe B. R.. Nuk rezulton që i padituri Q. R. të ketë kryer veprime për të ndërhyrë apo cenuar paditësen në gëzimin dhe posedimin e pasurive të paluajtshme të babait të saj. Paditësja, për këta persona të tjerë që janë vënë në posedim të disa prej pasurive që i takojnë paditëses për efekt trashëgimi, nuk ka paraqitur padi, për rrjedhim gjykata nuk mund të shprehet pas pasur kërkim”.*

Ndërsa, referuar aktekspertimit të datës 16.3.2018, në përgjigje të kërkesës nr. 2 të gjykatës me përmbajtje: *“të përcaktohet statusi i kësaj pasurie të paluajtshme nëse kjo pasuri e paluajtshme është e lirë apo e zënë dhe a ka ndërhyrje nga persona të tjerë”*, eksperti është përgjigjur: *“Lidhur me këtë kërkesë nga verifikimi në terren, rezulton si më poshtë: a. Pasuria me nr. \*\*\* është pronë e lirë dhe nuk ka ndërhyrje nga persona të tjerë; b. pasuria me nr. \*\*\* është pronë e lirë dhe nuk ka ndërhyrje nga persona të tjerë; c. pasuria me nr. \*\*\* është pronë mbi të cilën rezulton se brenda kësaj pasurie është përfshirë edhe prona e z. Amir Rata e paraqitur në planvendosjen bashkëngjitur dhe ortofoton digjitale treguese, i cili ka një ndërtesë bashkë me truallin...”*

Nga analiza e këtyre dokumenteve nuk u konstatuan kundërthënie mes aktekspertimit dhe pasqyrimin të tij në vendimin e gjykatës.

*Së dyti*, për sa i takon pretendimit se gjyqtarja vendosi rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova, u vlerësua se ky është një pretendim që lidhet thelbësisht me vendimmarrjen e gjyqtares, e cila mund të jetë objekt gjykimi nga një gjykatë më e lartë nëpërmjet të drejtës së ankimit të vendimit.

*Së treti*, denoncuesi ngrinte pretendime se gjyqtarja i ka mohuar denoncuesit të drejtën e përfaqësimit në gjykim të nënës së tij, si i paslindur i saj, duke i kërkuar në tri seanca të përfaqësohet me avokat, ndërkohë që nëna e tij kishte zgjedhur të vetëpërfaqësohej dhe mënyra e përfaqësimit ishte deklaruar që në seancën e parë. Sipas tij, qëllimi ishte të merrnin si avokate një miken e gjyqtares që quhej A. G.. Gjithashtu, denoncuesi ka pretenduar se gjyqtarja ka lejuar avokaten A. G. të shohë dosjen e paditësit pa qenë përfaqësuese e asnjërës prej palëve, si dhe pa pasur prokurë që t'i jepte të drejtën për të parë dosjen, ndërkohë që procesi ishte në vazhdim. Sipas denoncuesit, ai nuk kishte rënë dakord për pagesën me këtë avokate.

Subjektit, në lidhje me këto pretendime, iu kërkuar sqarime duke i kërkuar të vërë në dispozicion të Komisionit procesverbalet e seancave gjyqësore. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, duke deklaruar se pretendimet e shtetasit B. H. janë të pavërteta, znj. Alma Ahmeti sqaroi se shtetasja K. H. rezultonte si palë në gjykim në dy çështje gjyqësore që ajo kishte gjykuar, përkatësisht, në gjykimin civil përfunduar sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 21.3.2018 dhe gjykimin penal me objekt ankim kundër vendimit të mosfillimit nr. \*\*\*, datë 9.10.2017, me ankimues K. H., palë e interesuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe z. Q. R..

Në lidhje me çështjen që ka përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.3.2018, subjekti ka sqaruar se *janë zhvilluar katër seanca gjyqësore, përkatësisht në datat 31.1.2018, 15.2.2018, 6.3.2018 dhe 21.3.2018. Sipas saj, në seancën gjyqësore të datës 6.3.2018, kur palëve u janë treguar të drejtat dhe detyrimet procedurale janë pyetur nëse do të përfaqësohen vetë apo me përfaqësues ligjor, avokat. Të dyja palët ndërgjyqëse, paditëse K. H. dhe i padituri Q. R., kanë deklaruar se do të përfaqësohen dhe mbrohen vetë. Në asnjë seancë gjyqësore, shtetasja K. H. nuk ka kërkuar të përfaqësohet nga i biri B. H. dhe përgjatë gjithë gjykimit nuk i është kërkuar palëve të përfaqësohen me avokat apo t'i rekomandohet emri i ndonjë avokati.*

Në lidhje me gjykimin penal me objekt ankim kundër vendimit të mosfillimit nr. \*\*\*, datë 9.10.2017, me ankimues K. H., palë e interesuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe z.



Q. R., subjekti ka sqaruar se av. A. G. ka qenë avokate kryesisht për personin e interesuar Qemal Rata dhe si mbrojtëse e tij është njohur vetëm me aktet e gjykimit penal.

Subjekti i rivlerësimit, për të mbështetur pretendimet e saj, paraqiti akte të fashikullit gjyqësor të çështjes me palë paditëse K. H. dhe i paditur Q. R., përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.3.2018<sup>58</sup>, nga analiza e të cilave, në lidhje me pretendimin se denoncuesit i është mohuar e drejta e përfaqësimit të nënës së tij, u konstatua se ky pretendim nuk qëndron, pasi nga verifikimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore, nëna e denoncuesit K. H., pasi është pyetur nga gjyqtarja, ka deklaruar se do të përfaqësohej vetë pa kërkuar të përfaqësohej nga djali i saj B. H.. Nga ana tjetër nuk rezultoi që gjyqtarja t'i ketë kërkuar palëve të përfaqësohen me avokat.

Në lidhje me pretendimin sipas të cilit avokatja A. G. është njohur me aktet e gjykimit pa qenë avokate e asnjërës palë, nuk qëndron, pasi nga përmbajtja e vendimit nr. \*\*\*, datë 9.10.2017, rezulton se ajo ka qenë avokate për personin e interesuar Q. R. dhe në këtë cilësi dhe si mbrojtëse e tij është njohur me aktet e gjykimit penal.

#### 2.4 Shtatë denoncime nga shtetasi R. D.<sup>59</sup>

Në denoncimet e tij, ky shtetas ngrinte pretendime për korrupsion dhe pretendime për vendimmarrjen e prokurorëve të prokurorive të Kukësit dhe Shkodrës, si dhe gjyqtarëve e nëpunësve të Gjykatës së Kukësit dhe Shkodrës, ndër të cilët edhe gjyqtaren Alma Ahmeti. Siç vërehet, përveç faktit që denoncuesi nuk ka identifikuar ndonjë shkelje konkrete për subjektin e rivlerësimit, nuk ka referuar asnjë akt të lëshuar prej saj apo prova që të vërtetojnë pretendimet e tij.

#### 2.5 Denoncim nga shtetasi S. H.<sup>60</sup>

Në denoncimin e tij, ky shtetas ngrinte pretendime për zvarritje të gjykimit të çështjes së tij, si dhe për vendimin që subjekti i rivlerësimit ka marrë për pezullimin e gjykimit të çështjes së tij me arsyetimin se nuk gjendej e pandehura, pasi ajo ka marrë ryshfet nga e pandehura dhe babai i saj. Më tej, ai pretendon se pas hetimit të çështjes nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës, çështja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, në të cilën janë zhvilluar 8 seanca gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit dhe ky gjykim ende nuk ka përfunduar. Denoncuesi ka paraqitur bashkëngjitur denoncimit: (i) vendimin nr. \*\*\*, datë 31.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës për zgjidhje martesë; (ii) kallëzimin penal me datë 13.11.2017 për ish- bashkëshorten e tij M. H. (N.), në të cilin është pretenduar se ajo ishte larguar jashtë Shqipërisë që prej muajit gusht të vitit 2015, duke mos pasur asnjë prokurë prej denoncuesit për largimin e fëmijëve. Si rezultat, atij i është mohuar e drejta për të takuar fëmijët.

Në lidhje me këtë denoncim, në parashtrimet e saj subjekti i ka hedhur poshtë pretendimet e denoncuesit si të pabazuara. Subjekti ka sqaruar se shtetasi S. H. ka qenë palë në disa procese gjyqësore dhe vetëm në një çështje të gjykuar prej saj. Konkretisht ajo ka sqaruar se: *“Me vendimet nr. \*\*\*, datë 18.9.2013 dhe nr. 19, datë 17.9.2014, është lëshuar urdhër mbrojtje për*

<sup>58</sup> Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3.

<sup>59</sup> Shihni 7 denoncime nga shtetasi R. D., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2019; nr. \*\*\* prot., datë 20.8.2018; nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2018; nr. \*\*\* prot., datë 4.4.2018; nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2018; nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2018; nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2017 në dosjen e Komisionit.

<sup>60</sup> Shihni denoncimin nga shtetasi S. H., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2020, përcjellë nga KPA-ja, në dosjen e Komisionit.

*shtetasen M. N. dhe fëmijët për dhunën e ushtruar nga bashkëshorti S. H. me afat njëvjeçar dhe kjo shtetase ka qenë pranë Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje Tiranë. Ky shtetas, për shkeljen e urdhrin të mbrojtjes është dënuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.3.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës është vendosur zgjidhja e martesës mes shtetasve S. H. dhe M. N. (H.) dhe mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Në vendimet e mësipërme unë nuk kam qenë gjyqtare e çështjes”.*

Në vijim, subjekti ka sqaruar se ka gjykuar çështjen penale mbi bazën e kallëzimit penal të datës 13.11.2017, të shtetasit S. H., për ish-bashkëshorten e tij M. H., pasi kjo e fundit ishte larguar jashtë Shqipërisë që prej muajit gusht të vitit 2015, bashkë me fëmijët duke iu mohuar e drejta për të takuar fëmijët. Më tej, subjekti ka sqaruar se gjatë gjykimit të çështjes në themel, duke qenë se e pandehura M. N. ka qenë në mungesë, me vendimin e datës 16.4.2018, bazuar në nenin 352 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur pezullimin e gjykimit me afat njëvjeçar, dhe në përfundim të këtij afati, me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.9.2019, ka vendosur deklarimin fajtorë të të pandehurës M. N., për veprën penale “mosnjoftim i ndryshimit të vendbanimit”, parashikuar nga neni 126 i Kodit Penal.

Subjekti, për të vërtetuar pretendimet e saj, ka paraqitur dokumentet shkresore si vijojnë:

- vendim nr. \*\*\*, datë 18.9.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, gjyqtare D. V. “Për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes” për paditësen M. R. H.;
- vendim nr. \*\*\*, datë 17.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, gjyqtare D. V., për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes për paditësen M. R. N.;
- vendim nr. \*\*\*, datë 31.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, gjyqtar I. Sh., ku është vendosur zgjidhja e martesës ligjore ndërmjet paditësit S. H. dhe të paditurës M. H. të lidhur më 22.4.2003;
- vendim nr. \*\*\*, datë 6.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, gjyqtari G. Q., ku është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit S. H. për kryerjen e veprës penale “veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”.
- vendim nr. \*\*\*, datë 12.9.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, gjyqtarja Alma Ahmeti, ku është vendosur deklarimi fajtorë e të pandehurës M. N. për kryerjen e veprës penale “mosnjoftim i ndryshimit të vendbanimit”.

Bazuar në sa më sipër, nga analiza e këtij denoncimi, vërehet se pretendimi i denoncuesit se subjekti i rivlerësimit ka marrë ryshfet nga e pandehura, përveç se nuk mbështetet në ndonjë provë, nuk rezulton të jetë i mbështetur, pasi referuar vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit në përfundim të gjykimit, në të cilin e pandehura M. N. është deklaruar fajtorë, nuk konstatohen elemente njëanshmërie.

Për sa i takon pretendimit për zvarritje të gjykimit nëpërmjet vendimmarrjes së subjektit për pezullimin e gjykimit, duke qenë se nga ana e denoncuesit deklarohet se çështja ishte ende në gjykim, referuar përmbajtjes së vendimit nr. \*\*\*, datë 12.9.2019, rezultoi se pezullimi i gjykimit është vendosur për shkak të mosmarrjes dijeni të të pandehurës për gjykimin, në përputhje me nenin 352 të Kodit të Procedurës Penale, duke urdhëruar Komisaratin e Policisë Kukës që të vazhdojë kërkimet me qëllim gjetjen dhe njoftimin e të pandehurës M. N..

**3. Informacioni i vënë në dispozicion nga organet ligjzbatuese në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për çështjen penale nr. akti \*\*\*, që i përket palëve: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës kundër të pandehurit N. B., i akuzuar për veprën penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga**

neni 259 i Kodit Penal. Nga përmbajtja e këtij vendimi u konstatua se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pjesëmarrësit në gjykim kërkuan:

- Organi i akuzës kërkoi deklarinin fajtor të të pandehurit N. B., për kryerjen e veprës penale “korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim; në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të ulet me 1/3 e dënimit dhe dënimin e tij me 16 muaj burgim; mbështetur në nenin 59 të Kodit Penal, të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim duke e vënë të pandehurin në provë për një periudhë kohore prej 32 muajsh, me kusht që i pandehuri N. B. të mbajë kontakte me shërbimin e provës Kukës; shpenzimet procedurale hetimore në vlerën 8,000 lekë sipas faturës së fashikullit hetimor t’i ngarkohen të pandehurit N. B.”.

- Avokati mbrojtës i të pandehurit N. B. kërkoi “Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit N. B. akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, pasi nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën penale ”.

Trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, i përbërë nga gjyqtarët G. Q., Alma Ahmeti dhe S. U., pasi krijoi bindjen se autori i kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal është i pandehuri N. B., vlerësoi se ndaj tij duhet të aplikohet neni 59 i Kodit Penal, pasi rrezikshmëria e tij si person nuk është e madhe dhe se ai është kryefamiljar me gjashtë fëmijë dhe me bashkëshorte të papunë. Në përfundim, trupi gjykues vendosi:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit N. B., për kryerjen e veprës penale “korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim.

- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e dënimit dhe i pandehuri N. B., përfundimisht, dënohet me 16 muaj burgim. Vuajtja e dënimit për të pandehurin N. B. do të fillojë të llogaritet nga data e ndalimit të tij, 21.12.2016, dhe për pjesën e pavuajtur të dënimit, në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim duke e vënë të pandehurin në provë për një periudhë kohore prej 32 muajsh, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

- Në bazë të nenit 261/1/b të Kodit të Procedurës Penale shuhet masa e sigurimit “arrest me burg” caktuar me vendimet nr. \*\*\*, datë 23.12.2016 dhe nr. \*\*\*, datë 23.1.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit nga I EVP Kukës nëse nuk mbahet me masë tjetër.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me rrethanat mbi bazën e të cilave, nga ana e gjykatës është vendosur aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal, mbi pezullimin e dënimit me burgim.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

Subjekti, në parashtrimet e saj, duke nënvizuar se në këtë çështje ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, në lidhje me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, ka sqaruar se nga gjykata është aplikuar kjo alternativë e dënimit me burgim për shkak se i pandehuri ka qenë në kushte të vështira ekonomike, i pandehuri është kryefamiljar, babai i katër fëmijëve ku fëmija i madh ndiqte studimet në universitet dhe tre fëmijët e tjerë shkollën 9-vjeçare, bashkëshortja e tij ka rezultuar e papunë dhe i pandehuri ka qenë i vetmi që ka siguruar të ardhurat për familjen, i pandehuri ka qenë i padënuar më parë dhe në momentin e shpalljes së vendimit kishte vuajtur më shumë se gjysmën e dënimit. Për këto arsye, trupi gjykues e ka konsideruar të përshtatshme kërkesën e prokurorit për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, për pjesën e pavuajtur të dënimit.

Më tej, subjekti ka sqaruar se i pandehuri nuk ka qenë dakord me vendimin e gjykatës dhe e ka ankimuar në Gjykatën e Apelit Shkodër, duke kërkuar pafajësi. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.5.2019, Gjykata e Apelit Shkodër, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 30.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës”. Përsëri i pandehuri nuk ka qenë dakord me këtë vendim dhe ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë duke kërkuar pafajësi, gjykim i cili nuk ka përfunduar.

Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur: vendimin nr. \*\*\*, datë 30.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës; vendimin nr. \*\*\*, datë 9.5.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër; certifikatë familjare të shtetasit N. B. të datës 24.1.2017; vërtetim datë 24.1.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Punësimit Kukës për shtetasen V. B.; vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2017, lëshuar nga Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër; tri vërtetime datë 24.1.2017, lëshuar nga shkolla 9-vjeçare “R. S.”.

Sqarimet dhe rrethanat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal (vlerësim i cili në fakt lidhet me vendimmarrjen sipas bindjes së brendshme të gjyqtarit), nga ana e Komisionit vlerësohen bindëse dhe të tilla që justifikojnë aplikimin e kësaj dispozite ligjore. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi elemente që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit gjatë gjykimit të kësaj çështjeje penale, duke mbajtur gjithashtu në konsideratë edhe faktet dhe rrethanat, si vijojnë: (i) subjekti ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, e për më tepër vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër; (ii) qëndrimi i gjykatës ka qenë i njëjtë me kërkesën e organit të akuzës, për deklarimin fajtor të të pandehurit, i cili nga ana e tij ka kërkuar pafajësi, duke mos qenë dakord me vendimin e gjykatës duke bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

4. Informacioni i marrë nga KLGj-ja, etj., lidhur me ankesa, kallëzime apo masa disiplinore, nga ku rezultoi se në ngarkim të subjektit nuk ka pasur të tilla.

### **C/3 Rivlerësimi profesional sipas kritereve të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”**

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale sipas kritereve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerësoi se:

- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas gurmës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### **III. SEANCA DËGJIMORE**

Në datën 12.2.2021, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, në përfundim të së cilës, përfaqësuesja ligjore e saj kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, dhe shpalli këtë vendim sot, në datën 15.2.2021, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

#### **IV. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nëpërmjet përfaqësuesit ligjor gjatë seancës dëgjimore.

Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar, duke paraqitur në çdo rast dokumente shkresore për të vërtetuar për sa i është kërkuar nga Komisioni, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

#### **KONKLuzion Përfundimtar**

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit, sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se:

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.
2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.
3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germen “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

#### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Ahmeti, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 15.02.2021.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**  
**Kryesuese**

**Firdes SHULI**  
**Relatore**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Anisa Duka*